



HULUMTIM I POLITIKAVE
QEVERISËSE NË KULTURË
NË KOMUNAT E KOSOVËS

*Për të mirë
të popullsisë
së komunës*

Nëntor 2014, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian dhe Olof Palme International Center”

HULUMTIM I POLITIKAVE
QEVERISËSE NË KULTURË
NË KOMUNAT E KOSOVËS

Për të mirë të popullsisë së komunës

Autor:

Albert Heta dhe Donjete Murati



Projekt i financuar nga BE-ja
dhe i menaxhuar nga Zyra e
Bashkimit Evropian në Kosovë



Përmbajtja

Hyrje

Metodologjia

Kufizimet e Hulumtimit

Konteksti

Decentralizimi i Pushtetit dhe Decentralizmi i Kulturës

Pavarësia e Institucioneve Publike

Komunat në vitin 2014

Centralizmi në Komuna

Politikbërja dhe politikat aktuale

Kultura në investimet kapitale

Komuna dhe Institucionet e Pavarura të Kulturës

Komuna dhe Institucionet Publike të Kulturës

Qasja në vendimarrje

Qasja në resurset publike

Shpërndarja e buxhetit publik për institucionet e pavarura

Buxheti publik për Institucionet publike të kultures

Qasja në shfrytëzimin e pronës komunale për veprimtari kulturore

Shtojca I: Lista e të intervistuarve

HYRJE

Gjithpërfshirja, transparenca, qasja e barabartë në resurse publike dhe vendimarrje, si parime themelore të një shteti demokratik janë në fokus qendror mbi të cilat është zhvilluar projekti hulumtues “Kultura në Politika Komunale”. Këto parime primare të demokracisë përcjellin qellimisht hulumtimin i cili analizon politikat e kulturës në nivel komunal në Kosovë. Në këtë kontekst, niveli strategjik si caktimi i prioriteteve apo hartimi i politikave si hap i domosdoshëm për të krijuar modele të reja të politikave dhe institucioneve, si indikatorë të nivelit të politik – bërjës në një vend, nuk ekziston.

Diskutimet për strategji, dhe kërkesat për me pasë strategji të kulturës, në kohën kur nuk respektohen parimet elementare të transparencës, llogaridhëniës dhe përfshirjes në vendimarrje të sektorëve që drejtpërdrejt ndikohen nga vendimarrja, nuk janë asgjë tjetër kontribut për zgjatjen e kësaj gjendje.

Në rastin e Prishtinës, ndryshimi që duket minimal, në përbërjen e komisionit që i vlerëson projektet, i cili ka kriju hapësirë shoqnisë civile dhe ekspertëve, të marrë pjesë në evaluimin e projekteve që subvencionohen nga fondet publike që administrohen nga komuna, është bërë pa ndonjë strategji të kultures të bërë publike. Ky shembull tregon drejtpërdrejt që ndryshimet që sigurojnë rrespektimin e këtyre parimeve themelore të funksionimit të institucioneve, për të mirë të popullsisë së komunës, nuk kanë të bëjnë me ndonjë strategji të kulturës, por me sigurimin e funksionimit të demokracisë si vlerë e cila ido të duhej me sundu edhe në këtë shoqëri.

Ky projekt realizohet në një kontekst që dominohet nga mungesa e dokumenteve strategjike, dhe dokumenteve të detajuara për punën që kryejnë drejtoritë komunale në kulturë, të cilat në rast të hartimit dhe implementimit të tyre, kanë potencial të paraqesin mundësinë e

krijimit të indikatorëve matës, dhe do ta përbënin pjesën më të rëndësishme për vlerësimin e nivelit të zhvillimit të kulturës në politik-bërje në nivel komunal. Si rrjedhojë, raporti “Për të mirë të popullsisë së komunës” ka identifikuar zgjidhjet e përsëritura çdo vit në Kosovë.

Pozita e kulturës, dhe pozita e institucioneve të kulturës aktualisht paraqet edhe nivelin e zhvillimit të demokracisë në një shtet, e sidomos në nivel komunal, ku kultura sipas legjislacionit në fuqi për rregullimin e komunave është kompetencë vetanake¹ e komunës. Potenciali dhe mundësia për të krijuar dhe shpërndarë përmbajtje emancipuese dhe kritike në publik, në nivel komunal aktualisht rregullohet me ligje të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht, rëndësi substanciale në marrëdhëniet e shtetit me institucionet e kulturës dhe me

sektorin e kulturës paraqesin edhe rregulloret, statutet e komunës, apo akte të tjera të miratuara në nivel komunal. Këto dokumente paraqesin nivelin e mundësisë dhe të qasjes në përmbajtje kulturore për publikun.

Komunat aktualisht posedojnë mbështetjen ligjore për të krijuar dhe zbatuar politika strategjike të cilat nuk janë të rezervuara për nivelin qendror të vendimarrjes. Ky raport përpiqet të identifikoj praktikat aktuale në vendimarrje në nivel komunal, pozitën e institucioneve të kulturës në këto procese, qasjen në vendimarrje të këtyre institucioneve dhe përpiqet të identifikojë proceset e hartimit dhe implementimit të politikave publike në kulturë.

“Për të mirë të popullsisë së komunës”, hulumtim i politikave qeverisëse në kulturë në Komunat e Kosovës, është projekt hulumtues, që qëndron si analizë krahasuese që bazohet në hulumtimin e katër komunave si raste të studimit - Pr-

¹ Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 shkurt 2008.

I. INTRODUCTION

a look at the theoretical framework

ishtinën, Graçanicën, Prizrenin dhe Pejën.

Raporti tenton të analizoj poziten e institucioneve të pavarura dhe publike të kulturës në këto komuna, poziten e tyre në raport me vendimarrjen si dhe në qasjen në resurse publike dhe gjithashtu tenton të tërheq dhe t'i identifikojë dhe shpërfaqë dallimet dhe/ apo ngjashmëritë e dukshme nga këto katër raste të studimit. Vendimi që të analizohen politikat e këtyre komunave bazohet në madhësinë e komunave dhe partitë politike që i udhëheqin ekzekutivin e këtyre komunave, përkatësisht afërsitë partiake të kryetarit/ës së komunës, si i/e zgjedhur e drejtpërdrejt nga qytetarët, si dhe me faktin se paraqet politikat ekzekutive të komunave.

Prishtina, Kryetari i Komunës: Lëvizja Vetëvendosje

Partia me më së shumti deputetë në Kuvendin Komunal: LDK

Koalicioni qeverisës: Nuk ka

Prizren, Kryetari i Komunës: PDK

Partia me më së shumti deputetë të Kuvendin Komunal: PDK.

Koalicioni qeverisës: PDK, AAK-LDD, KDTP, VAKAT, NDS.

Graçanica, Kryetari i Komunës: Lista Srpska;

Partia me më së shumti deputetë të Kuvendin Komunal: Lista Srpska.

Koalicioni qeverisës: GIS, SLS, Kosova Roma deputy mayor (non-affiliated), Kosovo

Albanian (AAK-LDD), non affiliated.

Peja, Kryetari i Komunës: LDK

Partia me më së shumti deputetë të Kuvendin Komunal: LDK.

Koalicioni qeverisës: LDK, PDK, PD.

Analiza në mënyrën e shpërndarjes së resurseve publike, dhe niveli i qasjes dhe ndikimit në vendimarr-

je për shpërndarjen e këtyre resurseve paraqet pasqyrën kryesore të gjendjës së institucioneve publike dhe instituconeve të pavarura të kulturës karshi politikave komunale për kulturë. Aktualisht mënyra se si shpërndahen resurset publike paraqet një rën prej hapësirave të vetme ku mund të dallohet se cilat janë politikat e implemtuara nga secila komunë si dhe marrdhënien e tyre me këto institucione.

E ndërthurur në këtë raport qëndron analiza e ligjeve dhe akteve nën ligjore të cilat janë të aprovuara në Kuvend të Republikës së Kosovës, dhe në kuvende të komunave përkatëse. Në këtë raport ligjet bazë të cilat janë analizuar janë: Ligji për Vetqeverisje Lokale; Ligji për Financat e Pushtetit Lokal; Ligji për Dhënie në Shfrytëzim të Pronave Komunale; Ligji për Institucionet e Kulturës; Ligji për Teatrot; Ligji për Filhamorninë, Operën dhe Baletin; Statuti i Komunës së Prishtinës; Statuti i Komunës së Prizrenit; Statuti i Komunës së Graçanicës;

Statuti i Komunës së Pejës. Këto akte ligjore paraqesin të vetmet dokumente mbi të cilat mund të mbështetën zyrtarët gjatë kryerjës së punëve rreth menaxhimit kulturor.

“Për të mirë të popullsisë së komunës” tenton të analizoj shkallën e ndikimit të reformimit të qeverisjes lokale, dhe procesit të decentralizimit në Kosovë, proces i cili filloi në vitin 1999. Në Kosovë decentralizimi, krijimi i komunave të reja, si dhe pasojat e reformimit të qeverisjes lokale kanë pasë ndikime të mëdha në sektorin e kultures.

Së fundmi, ky hulumtim tenton të theksoj nëse në fakt, parimet demokratike si transparenca, gjithpërfshijra, dhe barazia janë parime mbi të cilat komunat veprojnë gjatë ushtrimit të pushtetit ekzekutiv, sa i përket sektorit të kulturës, pasi që është e evidente se pa asnjë përjashtim nuk ka politika tjera strategjike, apo prioritare për sektorin e kultures që zbatohen nga komunat.

Hulumtimi nuk ka për qëllim të paraqet pasqyre të detajuar rreth aktiviteteve kulturore në këto komuna, apo kualitetin e përmbajtjes që mundësohet nga këto politika. Raporti në fakt është analizë e rregullave të pashkruara qeverisëse në Kosovë, në nivel komunal se sa përjashtimet eventuale që ka gjasë të ndodhin. Përjashtime në këto rregulla janë edhe tipar i qeverisjes në kulturë në nivel komunal, pasi që niveli i zhvillimit të politikave strategjike në komuna nuk paraqet ndonjë zgjidhje strategjike apo programore.

METODOLOGJIA

Hulumtimi “Për të mirë të popullsisë së komunës” është kryer duke shfrytëzuar metoda kualitative, në kombinim të analizës së kornizës aktuale ligjore, dhe intervistave me bartësit e përgjegjësive të caktuara në kulturë në komunat përkatëse. Duke përfshirë përfaqësuesit e Drejtorive për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorët e institucioneve publike të kulturës, Drejtorët e institucioneve të pavarura të kulturës. Hulumtimi ka tentu me identifiku nivelin e demokratizimit në politikat aktuale dhe pozitën e institucioneve publike të kulturës dhe institucioneve të pavarura të kulturës në katër komuna të Kosovës: Prishtina, Graçanica, Prizreni dhe Peja.

Pyetjet hulumtuëse të cilat tenton ti përgjigjet projekti janë:

1. Cila është pozita e institucioneve të pavarura dhe institucioneve publike të kulturës në politikat e nivelit komunal sa i përket qasjes në resurse publike

2. Cila është pozita e institucioneve të pavarura dhe institucioneve publike të kulturës në politikat e nivelit komunal sa i përket në qasjes në vendimarrje

3. Si ka ndikuar Reforma e Qeverisjes lokale në sektorin e kulturës

Për t’u përgjigjur në këto tri pyetje hulumtuëse, në mungesë të dokumenteve strategjike apo akteve tjera ligjore, Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë, ka zhvilluar indikatorë duke u bazuar në përgjegjësitë e institucioneve dhe bartësve të përgjegjësive. Indikatorët janë ndarë në katër shtylla: Qasja në Vendimarrje, Shpërndarja e Resurse publike, Institucionet publike, Institucionet e pavarura.

Gjatë hulumtimit, fillimisht është bërë analiza e kornizës ligjore, dhe identifikimi i pozitës së institucioneve të kulturës në ligjet dhe rregulloret e komunës për kulturë. Pastaj është vazhduar në hartimin e pyetësoreve gjysmë-të strukturuar,

dhe të bërë veçmas për secilin të intervistuar, në mënyrë që të krahasohët dhe të nxirrën gjatë analizës dallimet dhe ngjashmëritë në hartimin dhe implementimin e politikave të komunave përkatëse. Pas intervistave, të dhënat janë grumbulluar në mënyrë që të krahasohen me komunitat të cilat kanë qenë raste të studimit.

KUFIZIMET E HULUMTIMIT

KUFIZIMET E HULUMTIMIT

Projekti hulumtues “Për të mirë të popullsisë së komunës” është kryer prej gushtit deri në tetor 2014. Ky moment kohor paraqet kufizim në hulumtim, pasi që zgjedhjet e fundit lokale në Kosovë janë mbajtur në dhjetor 2013. Si rezultat në tri nga katër komunat, Prishtinë, Graçanicë dhe Pejë, ka pasë ndryshime të mëdha në ekzekutivin dhe legjislativin e Komunës. Këto qeveri janë konstituuar në Janar 2014. Ndërsa në Prizren, kryetari i komunës i zgjedhur në zgjedhjet e kaluara është kryetari i komunës që e ka udhëhequr komunën në mandatin paraqark, ndërsa legjislativi ndryshon, dhe koalicionet të reja janë krijuar për qeverisjen në Komunë.

Kufizimi i dytë i hulumtimimit është që qeveritë e reja në 2014, deri në gjysmën e parë të vitit 2014 kanë punuar me buxhetin e vitit paraqark, të miratuar nga përbërja e kaluar e Kuvendit Komunal.

KONTEKSTI

Sipas të dhënave zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës, në komunën e Prishtinës është 1 Kinema, 1 Teatër Kombëtar, 1 Teatër Amator, 1 Teatër i fëmijëve, 1 Muze dhe 15 biblioteka. Në vitin 1986 është themeluar Teatri Dodona, ndërsa me vendim nr. 640 - 21390, e rithemeloj në vitin 2013 teatrin e fëmijëve dhe të kukullave Dodona, kuvendi i komunës së Prishtinës.² Në komunën e Pejës nën organogramin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport janë Biblioteka, Galeria e Arteve, Teatri Profesional, Muzeu Etnologjik, Kino-Teatri dhe Shtëpia e Kulturës.³ Në Graçanicë është 1 Teatër

Amator,⁴ dhe 3 Shtëpi të kulturës⁵ Ndërsa në Prizren, është 1 Kinema, 3 Shtëpi-Muze, dhe 3 Biblioteka.⁶ Si agjent i rëndësishëm i ndikimit

2 Kuvendi i Komunës, Komuna e Prishtinës, Vendim për themelimin e Teatrit të Qytetit Dodona, (Prishtinë, 2013).

3 Komuna e Pejës, "Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport": <https://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Kulture-,-Rinidhe-Sport.aspx> (qasur me gusht 2014).

4 Bashkim Ballaqa, Naime Rexhepi, Laureta Haziri, Seria 5:Statistikat Sociale: Statistikat e Kulturës 2012 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013).

5 Intervistë me Dragan , Drejtor, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës, Graçanicë, gusht 2014.

6 Bashkim Ballaqa, Naime Rexhepi, Laureta Haziri, Seria 5:Statistikat Sociale: Statistikat e Kulturës 2012 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013).

të korpusit shtetëror në sektorin e kulturës mbetet reforma e qeverisjes lokale. Bazat dhe themelet ligjore të qeverisjes lokale në Kosovë janë vendos me fillimin e vendosjes së rregulloreve të UNMIK-ut nga viti 1999. Dy vitet e para të reformimit të qeverisjes lokale karakterizohen me periudhën e “administrimit të komunave me Administrator komunal, sipas Rregullativave të UNMIK-ut.”⁷ Në Tetor të vitit 1999, u miratua rregullorja e parë e UNMIK-ut lidhur me qeverisjen e Komunave apo më saktësisht lidhur me emërimin e administratorëve komunal dhe rajonal. Sipas rregullorës 1999/14 të UNMIK-ut, ku thuhet “Administratorët komunalë kontrollojnë, zbatojnë apo mbikëqyrin funksionet që u janë besuar shërbimeve publike si dhe organeve të qeverisjes

lokale në komunat përkatëse dhe administratorët komunalë mund të kërkojnë që këto shërbime dhe organe të kërkojnë miratimin paraprak të tij/saj për vendime apo iniciativa të veçanta”.⁸ Me këtë rregullore, komunat kanë qenë nën-mbikëqyrje nga Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili në atë kohë ka pasë një administrator të komunës të emëruar nga ai në secilën komunë.⁹

Me 27 tetor të vitit 2000 u mbajtën zgjedhjet e para në nivel lokal në Kosovë dhe pas tyre, “30 komuna u bënë njësi themelore të vetëqeverisjes lokale.”¹⁰ Gjatë kësaj

8 Rregullore e UNMIK 1999/ 14, Rregullore për emërimin e administratorëve rajonal dhe komunal, tetor 1999.

9 OECD, Kosovo Decentralization Process, OECD <http://www.oecd.org/countries/serbiaandmontenegro/june2006/36502014.pdf>, (qasur me 4 tetor, 2014).

10 Instituti Gap, Themelimi i Komunave të reja në Kosovë Implikimet buxhetore dhe qëndrueshmëria vetë- financiare, (Prishtinë: Instituti Gap, korrik, 2013), fq.1.

7 Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Organizimi dhe Funksionimi i Qeverisjes Lokale në Kosovë,

(Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, gusht, 2013).

periudhe, deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës me 2008 dhe miratimit të ligjit për vetqeverisje lokale, Komunitatet në Kosovë, rregulloheshin në bazë të rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunitave të Kosovës, e cila vendosi një bazë juridike për vetqeverisje lokale.

“Ishte akti i parë regulativ me fuqi ligjore që vendosi themelet e një sistemi të vetëqeverisjes lokale demokratike.”¹¹ Sipas rregullorës së UNMIK-ut për vetqeverisje lokale, aktivitetet kulturore nuk paraqiten si kompetenca vetanake apo si obligim i komunitetit për të zhvilluar kushte të përshtatshme për zhvillimin dhe lulëzimin e kulturës në vend, sipas nenit 3.2 se “Përveç aktivitetëve të caktuara me nenin 3.1, komunitatet mund të ndërmarin veprime në territorin e tyre

edhe rreth qështjeve të tjera komunale”.¹² Në nenin që rregullon ‘aktivitetet vijuese’ të cilat qeveritë lokale ‘mund’ të implementojnë paraqitjen edhe aktivitetet kulturore, por jo edhe obligim ligjor sikur aktivitetet që paraqitën në nenin 3.1 të rregullorës së UNMIK-ut.

Gjatë kësaj kohe, nuk është hartuar asnjë rregullore e UNMIK-ut që rregullon fushëveprimin e kulturës në nivel lokal.¹³ Gjatë kësaj periudhe, kultura paraqitet në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, që kishte miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por e kishte nënshkruar Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara. Aty thuhet se Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes - IPVQ-të duhet të “Të ruajnë vendndodhjet me rëndësi fetare, historike ose kulturore për komunitet-

11 Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Organizimi dhe Funkcionimi i Qeverisjes Lokale në Kosovë, (Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, gusht, 2013).

12 Rregullorja e UNMIK 2000/45, Mbi vetëqeverisjen lokale në Kosovë, gusht 2000.

13 Për më shumë shihni Gazeta Zyrtare UNMIK: <http://www.unmikonline.org/regulations/>

tin në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse”.¹⁴

Në dokumentin e njejtë, në kapitullin 5, i cili rregullon përgjegjësitë e IPVQ-ve paraqitet edhe kultura. Edhe pse nuk është për nivelin lokal, rregullorja e UNMIK-ut e cila trajton sektorin e kulturës është 2001/19 me të cilën caktohen përgjegjësitë e IPVQ-ve, dhe ndër të tjera më saktësisht cakton edhe përgjegjësitë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Edhe pse kjo periudhë karakterizohet me zhvillime të rëndësishme për reformën e qeverisjes lokale dhe funksionimin e komunave si të tilla, njëkohësisht kjo periudhë shënohet edhe me zhvillime të rëndësishme në sektorin e kulturës.

Gjatë kësaj kohe është punuar në një strategji për kulturë në Kosovë, Strategjia e Zhvillimit të

Kulturës në Kosovë (2001 – 2003) e inicuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo strategji ka qenë dhe ende mund të jetë me rëndësi, edhe për zhvillimin e kapaciteteve të komunave. Publiku deri këtë vit nuk ka pasë qasje në asnjë nga dokumentet finale të prodhura nga ky proces. Publiku nuk ka qasje as në dokumentet që e kanë udhëhequr këtë proces”.¹⁵

Megjithatë, dokumente të strategjisë tanimë janë bërë publike, dhe në këto dokumente të strategjisë mund të shihet që ndërrmarja ka pasë synim dhe ka trajtuar rregullimin edhe të niveli lokal të menaxhimit të kulturës. Në këtë strategji, në të cilën Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtina ka arritur të ketë qasje, dhe e cila është përpiluar për këtë kontekst thuhet: “Secili autoritet lokal duhet të ketë strategjinë e vetë për zhvillimin

14 Kuvendi i Kosovës, Korniza Kushtetuese për vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Kuvendi i Kosovës: maj, 2001).

15 Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë, Kultura në Politikat Shtetërore (Prishtinë: Stacion – Qendra Për Art Bashkëkohor Prishtinë, 2014).

e kulturës. Kjo duhet të përfshijë dispozitat për shërbimet dhe infrastrukturë të kulturës, plane për turizëm të kulturës, prodhimin e artizanateve dhe marketing, festivale, kulturë në arsim dhe prezantimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore lokale. Kultura po ashtu duhet të jetë pjesë e rëndësishme dhe integrale e strategjive zhvillimore për ekonominë.”¹⁶

Gjejlane Hoxha në një intervistë për këtë proces ka thënë “Dokumentin nuk e ka përtërirë

askush, asnjëra prej ministrive.”¹⁷ Strategjia si proces është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me bartësit e institucioneve publike, me donatorë, si dhe me individ të shumtë të cilët kanë punuar në

16 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Strategjia e Zhvillimit të Kulturës në Kosovë.

17 Arbër Selmani, “Kosova ende pa strategji shtetërore për kulturën”, Gazeta Zeri, 23 qershor, 2013 <http://zeri.info/artikuli/8341/kosova-ende-pa-strategji-shtetërore-per-kulturen> (Qasur me 12 prill 2014)

art dhe kulturë në atë kohë. Megjithatë, janë identifikuar pjesë të zgjedhura të Strategjisë që janë implementuar dhe është identifikuar që Strategjia ende shërben si udhërrëfyes për disa zyrtarë të lartë të MKRS-së, por edhe për zyrtarë komunal.¹⁸

Drejtori i Galerisë së Arteve në Pejë, Zymer Mulliqi, në atë kohë, drejtor në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës tregon se në këtë proces “kanë marrë pjesë personalitete shumë të përkushtuar për diçka të mirë.” Ai vazhdon duke treguar se niveli i implementimit të strategjisë varet edhe nga “sa ato zbatohen, sa janë të realizueshme edhe sa ekziston dëshirë e vullnet. Kam tentu më ju përmbajt disa gjërave në strategji, për shembull “Themelimin e Institutit të Trashëgimisë Kulturore”.¹⁹

18 Intervistë me Kamuran Goranci, Drejtor, Departamenti i Kulturës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Prishtinë, 7 qershor 2014.

19 Intervistë me Zymer Mulliqi, Drejtor, Galeria e Arteve Pejë, Gusht 2014.

Sipas dokumenteve Strategjisë së Zhvillimit të Kulturës në Kosovë (2001 – 2003) në Kosovë do të duhej të krijoheshin hapësira ekspozuese në të gjitha komunat. Në këtë dokument thuhet se “Disa mund të jenë pronë dhe të menaxhohen nga autoritetet lokale, apo private, por të marrin

grante për punën e tyre nga Ministria e Kulturës. Disa mund të jenë pjesë e Qendrave për Kulturë nën Ministrinë e Kulturës, por të administrohen ndaras. ëëë Megjithatë qëllimi duhet të mbetet të sigurohet që asnjë qendër me banorë në Kosovë, të mos jetë pa hapësirë ekspozuese, që është e dizajnuar në mënyrë të duhur, me ndriçim të mjaftueshëm, me temperaturë të kontrolluar përbrenda shtatë viteve.”²⁰

Faza e dytë e reformës së qeverisjes lokale siç konstatohet në raporte qeveritare, filloi në vitin 2002 dhe

vazhdoi deri në vitin 2008, karakteristikat e të cilës përbëjnë periudhën “e administrimit të komunave pa administrator komunal sipas Rregulloreve të UNMIK-ut dhe akteve tjera ligjore të IPVQ, me transferim të kompetencave në organet e vetëqeverisjes lokale.”²¹ Në të njëjtën kohë në vitin 2002 janë themeluar Dokufest në Prizren dhe Teatri ODA në Prishtinë, me 2003 themelohet EXIT në Pejë, me 2006 themelohet Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë.

Sipas KIPRED, “Reforma e qeverisjes lokale u shndërrua në çështje të rëndësishme në tetor të vitit 2002, kur Përfaqësuesi i atëhershëm Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Michael Steiner, premtoi se do t’i decentralizonte strukturat e qeverisjes lokale, me shpresë se kjo do ta inkura-

21 Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Organizimi dhe Funkcionimi i Qeverisjës Lokale në Kosovë, (Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, gusht, 2013).

20 Dokumentet e Strategjisë për Kulturës (2001 – 2003)

jonte bashkësinë serbe që të dilte në zgjedhjet lokale”.²²

Aktualisht komunat janë rregullimi bazik shtetëror në Kosovë, territoret e të cilave janë caktuar në ish-Jugosllavi, edhe pse në vitin 1999 kanë pasë disa ndryshime të vogla²³, dhe më vonë në vitin 2005 dhe në vitin 2009²⁴. Me intensifikimin e procesit të përmbushjës së standardeve për Kosovën, Qeveria e Kosovës krijoi 5 komuna si ‘pilot projekte’, duke tentuar ta fuqizoj përfaqsimin e komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera jo-shqiptare. Komunat e reja të krijuara ishin Graçanica, Parteshi, Mamusha, Juniku dhe Hani i Elezit.²⁵

22 Era Gjurgjeala dhe Leon Malazogu, Qeverisja dhe Administrata Lokale në Kosovë, (Prishtinë: KIPRED, 2004), fq.1

23 OECD, Kosovo Decentralization Process, OECD <http://www.oecd.org/countries/serbiaandmontenegroprejune2006/36502014.pdf>, (qasur me 4 tetor, 2014).

24 Instituti Gap, Themelimi i Komunave të reja në Kosovë Implikimet buxhetore dhe qëndrueshmëria vetëfinanciare, (Prishtinë: Instituti Gap, korrik, 2013), fq.1.

25 Instituti Demokratik i Kosovës, Decen-

tralizimi në Kosovë, Përvojat nga Komuna e Prizrenit, (KDI, 2009), f.5.

Decentralizimi i Pushtetit dhe Decentralizimi i Kulturës

Pas periudhës së dytë të reformës së qeverisjes lokale, siç njihët në raporte qeveritare, në fazën e tretë ku qeverisët me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht në vitin 2010 fillon edhe decentralizimi i sektorit të kulturës.

Në raportin e realizuar nga Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë në korrik 2014 “Kultura në politikat shtetërore të Kosovës”, është identifikuar nevoja dhe dëshira e institucioneve publike të komunave për t’u shndërruar në institucione vartëse të MKRS-së. Disa prej këtyre institucioneve në të kaluarën ose më saktësisht para vitit 2010, para decentralizimit, kishin qenë institucione vartëse të MKRS-së. Kjo nevojë e institucioneve të kulturës në nivel publik komunal, për t’u kthyer nën vartësinë e MKRS-së është indikator për gjendjen e institucioneve në kulturë në nivel lokal, dhe është tregues i qartë i pozitës së institucioneve publike nën administrimin e komunave.

Me 2009, DFID ka publikuar një raport “Rishikimi funksional i Ministrisë së Kulturës - FRIDOM” raporti i cili ka rekomanduar decentralizimin e institucioneve të kulturës. Raporti thotë: “Lista e institucioneve të kulturës që janë nën vartësinë e MKRS-së është e gjerë. Do të ishte e dëshirueshme që të mbahen vetëm institucionet e rëndësisë kombëtare nën vartësinë e drejtpërdrejtë të MKRS-së”²⁶ konstatohet në këtë raport.

Deri në atë moment, Ministria e Kulturës nën vartësinë e vetë kishte shumë institucione, dhe në një gjendje të tillë “Institucionet kyçe kërkojnë miratimin e planeve vjetore të punës, buxhetet vjetore, projektet specifike dhe buxhetet e tyre – të gjitha të shkojnë përgjatë një procesi konsumues të kohës të vlerësimit dhe miratimit nëpërmjet të gjitha niveleve të hierarkisë së

26 Daniels Pavluts dhe Ilir Hoxha, Rishikimi Funksional i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, (Prishtinë: FRIDOM, 2009)

MKRS-së.” Sipas FRIDOM kjo ka ndikuar në kufizimin e autonomisë operacionale të këtyre institucioneve.. “Autonomia operacionale e institucioneve vartëse ka arritur pikën ku është e paqartë nëse institucionet operojnë si organe autonome ose si departamente të brendshme në vetë MKRS-së.”²⁷

Ky raport i ka rekomanduar MKRS-së të decentralizojë një pjesë të institucioneve të kulturës dhe të ketë nën vartësinë e vet, vetëm institucionet të cilat kanë rëndësi ‘kombëtare’. Kështu me 1 janar 2010, është nënshkruar një marrëveshje e mirëkuptimit në mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministrisë së Pushtetit Lokal, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe kuvendeve komunale, sipas së cilës menaxhimi i teatrove profesioniste të qyteteve nga niveli qendror kalon në nivel komunal.²⁸ Ky veprim ka rezultuar me kalimin e disa insti-

tucioneve në vartësinë e komunave, dhe ka shënuar fillimin e procesit të reformës ligjore për ligjin e teatrit. Në Marrëveshjen mes komunës së Prizrenit dhe Ministrisë së Kulturës thuhet se “Ky qëllim do të përmbushet nga MKRS-ja, me delegimin e kompetencës për teatrin (aktivitetet kulturore dhe të lira), për Komunën e Prizrenit, me kusht që Komuna e Prizrenit të demonstrojë kompetencën e kërkuar për përmbushjen e përgjegjësive të kërkuara konform legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjes së nënshkruar.”²⁹

Me 2010, kjo strukturë paraqitet në një dokument zyrtar të MKRS-së. Në Rregulloren Për Organizimin dhe Funkcionimin e Brendshëm të MKRS³⁰, konstatohet për herë të parë se cilat janë institucionet ‘e’ Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe bëhen institucione kulturore kombëtare:

29 Qeveria e Republikës së Kosovës, Marrëveshje e Mirëkuptimit për delegimin e kompetencave për teatrin në nivel komuna, Qeveria e Republikës së Kosovës.
30 Rregullorja për organizimin, neni 10

27 Po aty.

28 <http://www.ekonomia-ks.com/?page=1,5,1898>

1. Muzeu i Kosovës dhe rrjeti i tij,
2. Teatri Kombëtar i Kosovës,
3. Instituti i Kosovës për Konservim dhe Resturim dhe rrjeti i tij,
4. Instituti Arkeologjik i Kosovës
5. Filharmonia, Opera dhe Baleti i Kosovës
6. Biblioteka Kombëtare e Kosovës
7. Ansambli i Valleve dhe këngëve “Shota”,
8. Galeria e Arteve të Kosovës,
9. Qendra Kinematografike e Kosovës,
10. Kosova filmi”³¹

Si pasojë, pjesa tjetër e institucioneve ishte decentralizuar në komunat ku gjindëshin, dhe kështu filloi procesi i amandementimit të ligjit për teatrin të miratuar në vitin 2005, sipas të cilit teatrot mund të financoheshin nga “Mjetet për punën e teatrove publike sigurohen nga: Buxheti i MKRS; Buxheti

i Qytetit, përkatësisht i Komunës; Të hyrat vetanake, të realizuara nga veprimtaria e teatrove; testamenti, sponsorët, dhuratat dhe të hyrat tjera”³² Si pasojë e këtij reformimi të ligjit, teatrot e decentralizuar në ligjin e ri, menaxhohen dhe financohen nga Komunitet. Sipas Jeton Neziraj, Drejtor i Multimedias dhe ish-drejtor i Teatrit Kombëtar të Kosovës (2009-2011), reformimi “e ka paralizuar jetën teatrore. Ky ligj i cili e ka shkarkuar prej kompetencës Ministrinë, e komunat në atë kohë insistojshin me pasë kompetencat, sepse kanë menduar që kjo ju sjellë beneficione. Kjo në fakt ju ka sjellë beneficione, vetëm në zgjedhjen e drejtorëve. Për ta teatri është njëri ‘ndër’ instituconet, i hedhin rreth 10, 15 mijë euro në vit, edhe për ta këtu përfundon krejt puna.”³³

Pas kësaj periudhe institucionet publike të kulturës kanë kaluar nga

31 Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë, Kultura në Politikat Shtetërore (Prishtinë: Stacion – Qendra Për Art Bashkëkohor Prishtinë, 2014).

32 Ligji Nr. 02/L-12 Për Teatrin, 23 mars 2005

33 Intervistë me Jeton Neziraj, Drejtor, Qendra Multimedia, Prishtinë, Maj 2014.

varësia e MKRS-së nën varësinë e komunave. Por kjo nuk ka ndryshuar asgjë në lidhje me si menaxhohen, apo si përpilojnë dhe miratojnë këto institucione programin. Por, si rezultat i procesit të ‘decentralizimit’ të institucioneve të kulturës, ka ndryshuar instance të cilat ‘varën’, por edhe niveli i buxhetit programor të këtyre institucioneve. Pas ‘decentralizimit’ buxheti i këtyre institucioneve ‘dramatikisht’ është zvogëluar. Drejtori i Teatrit Dodona është shprehur se “ka shumë inciativa të institucioneve publike për t’u bërë teatro “kombëtar”, pasi që nën – varësinë e Ministrisë është më e sigurt financimi i programit”

Bekim Lumi, dikur këshilltar i Ministrisë të Kulturës (2008-2010), tregon se gjatë kohës kur ka qenë duke u amandamentuar Ligji për Teatrin, e ka organizuar një peticion kundër, i cili është nënshkruar nga 40 emra kredibil të fushës, “praktikisht teatrot e qyteteve janë të paralizuara, nuk funksionojnë gati fare në mungesë të mjeteve buxhetore,

për shkak se kryetarët e komunave, nuk e dinë rëndësinë e artit dhe për këtë arsye nuk ndajnë fonde për, ndonëse ligji e thotë se ato duhet të ndajnë fonde dhe ato janë të detyruar të ndajnë fonde për këto teatro.

Por këta nuk i ndajnë ato mjete, dhe jeta e teatrove krijuese nëpër qytete është paralizuar, pikërisht për shkak të atyre mjeteve, dhe për shkak të kornizës ligjore e cila i ka privu që ato të marrin buxhet drejtpërdrejt nga Ministria e Kulturës, përveç një pakoje prej 10,000 euro që atyre ju ndahet në kuadër të konkursit për promovim të kulturës, ku iu ndahen edhe OJQ-ve edhe rrjetit të pavarur, gjë që është paradoksale sepse përzihën edhe institucionet publike.”³⁴ Si rezultat teatrot e qyteteve të cilat kishin një buxhet që përafërsisht minimum ishte 50,000 deri 90,000 euro³⁵ iu është reduktuar buxheti

34 Intervistë me Bekim Lumi, Regjisor/ Profesor, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, maj 2014.

35 Intervistë me Bekim Lumi, Regjisor/

në 5,000 nga buxheti i komunave dhe 10,000 që marrin çdo vit nga konkursi i hapur³⁶.

Procesi i decentralizimit të pushtetit lokal edhe pse i nisur si tentim për përfshirjen e komunitetit serb në zgjedhje, në kulturë si proces nuk ka shënuar vetëm ndikimin më të madh të politikbërjes të nivelit qëndror në nivelin lokal, por edhe vetëm bartjen e kompetencave nga një nivel i pushtetit në tjetrin dhe jo edhe decentralizimin, pavarësimin dhe fuqizimin e produktionit kulturor të institucioneve publike në komuna.

Profesor, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, maj 2014.

36 Vija buxhetore 805, apo vija për promovim kulturor lejon që institucionet publike të kulturës të aplikojnë

Komunat në vitin 2014

Aktualisht komunat rregullohen “sipas Kushtetutës dhe Ligjeve të miratuara nga Kuvendi Republikës së Kosovës”³⁷ Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Neni 12, Komunat janë njësia themelore e vetqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës³⁸, e cila mund të ushtroj tërë pushtetin i cili nuk rezervohet shprehimisht për institucionet qendrore³⁹ Ligji për vetqeverisje lokale “përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet Brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkuftar dhe

37 Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Organizimi dhe Funksionimi i Qeverisjes Lokale në Kosovë, (Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, gusht, 2013).

38 Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008).

39 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovë, 20 shkurt 2008.

marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror”⁴⁰ Ligji për vetqeverisje lokale mundëson që “kultura dhe aktiviteti i lirë” të jenë kompetenca vetanake të komunës.

Komunat, sipas legjislacionit në fuqi, kanë nivel të lartë të autonomisë në mënyrën se si funksionojnë, në mënyrën se si i caktojnë ndarjet buxhetore por po ashtu në hartimin e politikave publike. Komunat kanë autonomi të plotë edhe të drejtë të bëjnë ndryshime strukturore në qeverisje, e sidomos në mënyrën se si komunat si mekanizma të vetëqeverisjes lokale e trajtojnë artin dhe kulturën. Komunat në vitin 2014 udhëhiqen nga Kuvendi Komunal, dhe Kryetari/ja e Komunës, aktualisht dy instanca të cilat zgjedhën drejtpërdrejt nga qytetarët e komunës në zgjedhje demokratike.

40 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovë, 20 shkurt 2008.

Komitetet e komunës, të cilat përbëhen nga anëtarët e kuvendit të komunes dhe përfaqësojnë përbërjen partiake të kuvendit komunal, përbëjnë një pjesë të rëndësishme të qeverisjes në komuna, pasi që anëtarët e kuvendit komunal përcaktohen në fusha përkatëse dhe kanë mundësi të shtjellimit të çështjeve në mënyrë më të hollësishme dhe specifike. Komitetet e Kuvendit Komunal të komunës, mund të themelohen nga Kuvendet, sipas nevojës.

Në Ligji për vetqeverisje lokale parashihet krijimi i dy komiteteve të përhershme “51.1 Kuvendet komunale themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.”⁴¹ Ndërsa komitetet tjera themelohen me anë të vendimeve të kuvendit komunal, si dhe veprimtaria e tyre përcaktohet me rregullore të komunës. Sipas nenit

52.2 të ligjit për vetqeverisje lokale “Kuvendi i komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme”⁴²

Themelimi i komiteteve të tjera, përkatësisht komitetit për kulturë është me rëndësi të posaqme pasi që një vendim i tillë krijon mekanizma dhe kapacitete shtesë për mundësinë e zhvillimit të politikave komunale në sektorin e kulturës. Njëkohësisht një vendim i tillë i kuvendit komunal, është indikator për qasjen që e ka një komunë dhe në cilën shkallë të prioriteteve që një komunë ka ndaj zhvillimit të aktiviteteve të kulturës.

Edhe pse në asnjë komunë, deri më tani, nuk është themeluar një komitet i vetëm për kulturë, gjatë hulumtimit është kuptuar se komuna e Prishtinës, qysh nga viti 2003 ka themeluar komitete ku është përfshi kultura. Në atë kohë ky komitet

41 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 shkurt 2008.

42 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 shkurt 2008.

ishte Komiteti për Kulturë, Rini, Sport dhe Gjini⁴³. Gjatë hulumtimit është kuptuar se ky komitet, gjatë periudhës 2003-2007 ka shërbyer edhe si komision për vlerësimin e projekteve të subvencioneve.⁴⁴

Në Komunën e Prishtinës, me 2010 Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar një rregullore për veprimtarinë e komiteteve ku caktohen të gjitha kompetencat e komiteteve përkatëse. Në këtë rregullore thuhet “Komitetet e lehtësojnë punën e Kuvendit, duke e racionalizuar kohën e marrjes së vendimeve”⁴⁵ Nga viti 2014 edhe Peja ka themeluar komitetin për kulturë, rini dhe sport. Por kompetencat

sipas këtij vendimi caktohen me statutin e Pejës. Ndërsa nuk ka të dhëna zyrtare mbi faktin se a është themeluar ndonjëherë komiteti për kulturë në kuvendin komunal të Graçanicës. Kurse në Prizren, të dhënat zyrtare paraqesin vetëm Komitetet e Përhershme.

43 Shihni vendimet: 01 Nr. 110-182, më 28.1.2010; vendimin 01.Nr.020-201, më 25.02.2008; vendimin 01 nr.110 – 76464, më 31.3.2014 01.Nr. 020-157 Data. 07.02.2003 të kuvendit të komunës së Prishtinës

44 Intersvistë me Mustafë Halili, Drejtor (2002 – 2007), Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës.

45 Komuna e Prishtinës, Rregullore për Përbërjën dhe kompetencat e komiteteve (Prishtinë: Komuna e Prishtinës, 2010).

Centralizmi në Komuna

Ekzekutivi i komunës përbëhet nga Kryetari/ja i/e Komunës dhe drejtoritë e komunës, të cilat kanë kompetenca të deleguara nga kryetari/ja i/e komunës për hartimin e politikave zhvillimore në fusha përkatëse. Në Prishtinë, Prizren, dhe Pejë ka Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport. Në Komunë e Graçanicës, ka Drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport. Drejtoritë për kulturë sipas portfolios kanë përgjegjësi ekzkluzive në hartimin dhe implementimin e politikave të kulturës apo më saktësisht në hartimin e “politikave zhvillimore në fushën e trashëgimisë kulturore, të artit skenik-muzikor, arteve pamore, botimeve dhe bibliotekar-in në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare.”⁴⁶

46 Komuna e Prishtinës, “Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport” <https://kk.rksgov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit.aspx> (qasur me gusht 2014) dhe Komuna e Pejës, “Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport” <https://kk.rks-gov.net/peje/Departments/Kulture,-Rini-dhe-Sport.aspx> (qasur me gusht 2014).

28 • PËR TË MIRË TË POPULLSISË SË KOMUNËS

Aktualisht, ligji për vetëqeverisje lokale, parasheh që kryetarët e komunave ndër të tjera, të kenë të drejtë dhe nën autoritetin e tyre propozimin e planeve rregullative dhe investuese, propozimin e buxhetit vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe po ashtu ta ekzekutojnë këtë buxhet.

Sipas Ligjit për vetqeverisje lokale drejtoratet dhe drejtorët e tyre, nuk kanë më autonomi në hartimin e politikave. “Me ligjin e ri për vetëqeverisje lokale dhe kompetencat e parapara të kryetarëve të komunave, kryetari tash i ka drejtorët këshilltar, dhe nuk i ka ma drejtorë. Këta munden me këshillu, por ai vendosë vet”.⁴⁷

Sipas Nenit 62, të Ligjit për vetqeverisje lokale:

62.1 Administrata komunale organizohet në drejtorate.

62.2 Çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori i cili emërohet

47 Intervistë me Zyrtar në Prizren

dhe shkarkohet nga kryetari.

62.3 Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

62.4 Drejtorët i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

POLITIKËBËRJA DHE POLITIKAT AKTUALE

Në këtë pjesë të raportit përshkruhen proceset e politik-bërjes dhe dokumentet në bazë të të cilave vepron ekzekutivi i komunave që kanë qenë pjesë e studimit krahasues “Për të mirë të popullsisë së komunës”.

Në vitin 2014 asnjë autoritet lokal nuk e ka strategjinë e vet për zhvillimin e kulturës⁴⁸. Në vitin 2014 nuk ka hapësira ekspozuese në të gjitha komunat. Në vitin 2014 nuk ka hapësira ekspozuese në shumicën e komunave dhe ky nuk është i vetmi tregues për ngecjet në krijimin e politikave dhe hapësirës së domosdoshme për lulëzimin e kulturës në nivelin komunal. Në vitin 2014 në nivelin qendror nuk ka Strategji të Kulturës apo Program Kombëtar të Kulturës apo ligj bazik për Kulturën, dhe nuk është themeluar ndonjë mekanizëm që i ngjan Këshillit Komunal për Kulturë që parashihet edhe me strategjinë për Kulturë 2001 – 2003. “Këshilli Komunal për

Kulturë do të bënte mbledhjen e të dhënave për artefaktet kulturore dhe organizatat në secilin hapësirë të autoritetit lokal. Do të mund të bëhet në mënyrë efektive regjistri statistikorë për kulturë në Kosovë, duke mndësuar Ministrinë e Kulturës dhe autoritetet lokale që të kenë një hartë të saktë të pasurisë kulturore të vendit. Do të përfshinte përshembull, ndërtesa publike apo private me kualitet të lartë, vepra me rëndësi artistike, monumente, organizata të artit performues, library, arkiva të rëndësishme publike dhe private, artist, shkrimtarë, dhe muzicientë, njerëz që punojnë artizanale, dhe vende me rëndësi historike.”⁴⁹

Edhe pse Burimi i të dhënave për Agjencionin e Statistikave janë Drejtoritë për Kulturë, Rini dhe Sport. Sipas legjislacionit në fuqi, Agjencioni i Statistikave është institucion i pavarur, dhe institucionet tjera e kanë obligim ligjor të përgjigjen në

48 Dokumentet e Strategjisë së Zhvillimit të Kulturës në Kosovë (2001 – 2003)

49 Dokumentet e Strategjisë së Zhvillimit të Kulturës në Kosovë (2001 – 2003)

pyetsorët e agjencionit të Statistikave të Kosovës.⁵⁰ Të dhëna zyrtare mbi veprimtarinë e institucioneve të pavarura që nuk janë të themeluara nga komunat nuk gjinden në të dhënat zyrtare të Agjencionit të Statistikave të Kosovës. “Praktika e mos njohjes ligjore⁵¹ dhe institucionale të institucioneve të pavarura në Kosovë shfaqet e qartë edhe në shënimet Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Publikimi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës përmban të dhëna statistikore lidhur me “aktivitetet kulturore të Kinemave, Teatrove, Galerive, Muzeve, Bibliotekave, Ansambleve si dhe përmban të dhëna për numrin e të punësuarve”⁵² nëpër institucionet publike të kulturës. Në këto publikime nuk ka të dhëna statistiko-

50 Ligji për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës, Ligji nr 04/L-036, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2011.

51 Shih kapitullin e analizës së kornizës ligjore në faqe

52 Bashkim Ballaqa, Naime Rexhepi, Laureta Haziri, Seria 5:Statistikat Sociale: Statistikat e Kulturës 2012 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013).

re lidhur me aktivitetet kulturore të Kinemave, Teatrove, Galerive, Muzeve, Bibliotekave, Ansambleve apo Festivaleve të pavarura. Raporti nuk përmban as të dhëna për numrin e të punësuarve nëpër institucione e pavarura të kulturës.”⁵³ Edhe pse Agjencia e Statistikave të Kosovës njih si institucion apo Galeri edhe Galerinë e Minsitrisë së Kulturës, një zyre e MKRS-së që funksionon jashtë ligjeve ekzistuese për kulturën dhe nuk është e regjistruar si institucion i kulturës.”⁵⁴

Aktualisht, baza e indikatorëve, dhe formularëve mbi të cilat janë të hartuara specifikisht për kulturë statistika paraqesin vetëm aktivitet kulturore që mbahën në institucionet publike të kulturës në varësi apo organe të institucioneve të shtetit

53 Stacion – Qendra për Art Bashkëkohor Prishtinë, Kultura në Politikën Shtetërore (Prishtinë: Stacion – Qendra Për Art Bashkëkohor Prishtinë, 2014).

54 Bashkim Ballaqa, Naime Rexhepi, Laureta Haziri, Seria 5:Statistikat Sociale: Statistikat e Kulturës 2012 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013).

dhe premisat, apo sallat që janë në pronësi të këtyre institucioneve.⁵⁵

Në këto formulare mund të regjistrohen edhe aktivitetet të cilat i ka mbajtur ndonjë institucion tjetër i kulturës, mirëpo, ngjarja duhet të ketë ndodhur në institucionet publike të kulturës publike. Institucionet e pavarura të kulturës nuk regjistrohen si institucionet në këtë agjenci. Kjo me një përjashtim, në Prishtinë, Agjencia e Statistikave të Kosovës i regjistron aktivitetet e teatrit Oda, institucion i pavarur i kulturës. Gjatë intervistave është kuptuar që kjo ka ndodhur për shkak të “vonesave të shumta që Agjencia ka hasë nga komuna e Prishtinës për dërgimin e të dhënave”, një zyrtare e Agjencionit ka vendosë vetë ta kryejë këtë punë. Në këtë rast, agjencionit pa koordinim me komunën vet e bën mbledhjen e të

dhënave⁵⁶.

Zyrtarët nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës kanë thënë se “do të mendojnë të shtojnë në planin e punës për vitin 2016 edhe indikatorë shtesë ku mund të përfshihen edhe institucionet tjera, sikur festivalet”⁵⁷ Këto statistika nuk janë problematike vetëm pse nuk regjistrojnë ngjarjet kulturore dhe institucionet e pavarura të kulturës dhe punëtorët e kulturës që punojnë në këto institucione, por gjithashtu paraqesin problem për pasqyrimin real të të dhënave për institucionet dhe aktivitetet e kulturës në Kosovë, që do duhej të ishte bazë për krijimin e politikave zhvillimore

në kulturë edhe në nivelin komunal. Këto të dhëna po ashtu janë

56 Intervistë me Departamentin e Statistikave Sociale, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë, Tetor 2014.

57 Intervistë me Departamentin e Statistikave Sociale, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë, Tetor 2014.

55 Intervistë me Departamentin e Statistikave Sociale, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Prishtinë, Tetor 2014.

problematike edhe pasi që me këto statistika zhduket një pjese e punës që përkrahet nga fondet publike, që në këtë rast administrohen nga komunat.

Edhe pse Komunat, sipas legjislacionit në fuqi, kanë nivel të lartë të autonomisë në mënyrën se si funksionojnë, në mënyrën se si i caktojnë ndarjet buxhetore por po ashtu në hartimin e politikave publike, aktualisht në asnjërën prej komunave të cilat janë hulumtuar, nuk ka strategji për kulturë që është në fuqi, dokumente ose plan programe tjera strategjike sektoriale, të cilat mund të paraqesin politika të menduara qëllimisht për artin dhe kulturën. “Unë prej fillimit kam qenë ma skeptik në kuptimin e rregullimit të kulturës me ligje. Unë mendoj që problemet në kulturë zgjidhen me politika kulturore. Për shembull, nëse ministria e ka një strategji që parasheh që brenda 3 ose 5 viteve të ardhshme dëshiron me mbërri diku, për me mbërri atje

duhët të krijoj njësi matëse të cilat parashihën si hapa drejt realizmit të një synimi. Jo me ligje”.⁵⁸

Në Prishtinë deri në vitin 2011, komuna ka pasë një Strategji për Komunën e Prishtinës. Në këtë strategji ku janë trajtuar të gjitha sektorët, gjendja e kulturës është trajtuar duke konstatuar gjendjen. Në Strategji e cila ishte përpiluar në vitin 2007 thuhej “Sektori i kulturës ballafaqohet me vështirësi të mëdha për shkak të mungesës së mjeteve materiale, resurseve njerëzore dhe infrastrukturës fizike ku do të zhvillohej veprimtaria kulturore.”⁵⁹ Në këtë strategji nuk parashihët ndonjë plan apo strategji se si të sfidohen vështirësitë. E vetmja fjali, e cila mund t’i ngjan një tentimit për të bërë një plan, thuhet “kujdesi i institucioneve në prezantimin e vlerave kulturore të

58 Intervistë me Florent Mehmeti, Drejtor, Teatri ODA, prill 2013.

59 Komuna e Prishtinës, Strategjia afatmesme e Zhvillimore e Komunës së Prishtinës 2008-2011 (Prishtinë: Komuna e Prishtinës, 2008).

qytetit duhet të jetë dukshëm më i fokusuar”⁶⁰.

Aktualisht Prishtina nuk ka strategji për komunë, apo strategji për kulturë. Ndërsa me zgjedhjet e reja, zyrtarët e komunës së Prishtinës kanë thënë se e kanë në plan të hartojnë një strategji për kulturë deri në fillim të vitit të ardhshëm⁶¹. Blerta Zeqiri për hulumtimin ka thënë “strategjia për kulturë është duke u planifikuar të përpilohet me ndihmën e organizatave dhe institucioneve të pavarura të kulturës. Qeveria e tanishme po ashtu ka mbajtur disa takime me individ të ndryshëm të fushës së kulturës në lidhje me propozimet që ata i kanë për fushën e kulturës.”⁶²

Sipas kryetarit të Komunës së Prishtinës, në Komunën e Prishtinës do të bëhet një ri-organizim edhe se si hartohen politikat në Komunën e

60 Po aty.

61 Intervistë me Blerta Zeqiri, Drejtore, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës, Prishtinë, Prill 2014.

62 Po aty.

Prishtinës. Shpend Ahmeti për hulumtimin “Për të mirë të popullsisë së komunës” ka thënë se “në komunë do të krijohet një drejtori për planifikim strategjik dhe jo vetëm për këtë aspektin planin zhvillimor, por në përgjithësi për të menduar për zhvillimet afat-mesme dhe afat-gjata. Jo me në secilin vit me diskutu buxhetin. Kjo drejtori ka me u marrë edhe me këtë lëmi. Sot drejtoresë së kulturës i duhet me u marrë me prokurorimin për pishinë. Pse me u marrë ajo me prokurorim, ajo duhet me thanë ‘na duhet një pishinë’. Tani duhet me pasë një drejtori të investimeve kapitale që merret me atë punë.

Sot drejtoresha e kulturës merrt me gjëra që s’kanë të bëjnë me politikë të kulturës. Kjo drejtori nuk ka me qenë drejtori shumë e madhe. Për këtë drejtori kemi me përdorë kapacitete edhe brenda komunës edhe jashtë”⁶³

63 Intervistë me Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Komuna e Prishtinës, Prishtinë, Maj 2014.

Në Prizren, gjatë një periudhe 3 vjeçare është hartuar Strategjia Orientuese për Zhvillimin Kulturor në Komunën e Prizrenit (2012 – 2016), dokument i hartuar nga Teatri ODA në bashkëpunim me Komunën. Kjo strategji është aprovuar në kuvendin komunal të komunës. Sipas organizatave të shoqërisë civile në komunën e Prizrenit drafti i fundit që e kanë analizuar nuk e ka pasë përmbajtjen e strategjisë “Nuk është as plan. Por më shumë i ngjan një hulumtimi”, ka thënë Valon Xhabali nga organizata EC Ma Ndryshe për gazetën Koha Ditore.⁶⁴ “Në Prizren e kemi bo një kornizë për shkak se i kemi hapë rrugë RROK-ut për me zhvillu një strategji” ka thënë Florent Mehmeti, Drejtor i Teatrit ODA, për hulumtimin.

Në fakt, njëri nga dy rekomandimet që gjenden në këtë dokument

64 Koha Net, “OJQ-të dhe Artistët Skepitikë për “strategjinë orientuese” në Prizren,” 15 Janar 2013 <http://koha.net/arkiva/?page=1,5,130952> (qasur me: Shtator 2014).

është zbatuar. Propozimi “blerja e një vendtakimi mobil me kapacitetet të lartë për skenimin e ngjarjeve”⁶⁵ është realizuar nga Drejtoria për Turizëm, ndërsa rekomandimi “formimi i një Këshilli për Art dhe Kulturë me qëllim të ngritjes së profilit dhe prioriteteve për artin dhe kulturën në qytet dhe për të këshilluar Komunën për krijimin e një strategjie kulturore”⁶⁶, nuk është implementuar.

Në komunën e Prizrenit, Drejtori për Turizëm, në lidhje më përpilimin e Strategjisë për Turizmin kanë vendos të bashkëpunojnë me organizatat jo qeveritare. “Te na të gjitha organizatat jo qeveritare thirrën për me u konsultu. Dhe kemi rënë dakord që procesin ta shtyjë RROK në patronatin e Drejtorisë

65 Komuna e Prizrenit dhe Teatri ODA, Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012 - 2016 (Teatri ODA, 2012).

66 Komuna e Prizrenit dhe Teatri ODA, Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012 - 2016 (Teatri ODA, 2012).

për Turizëm.”⁶⁷

Por, sipas Veton Nurkollarit gjendja e kulturës në këtë komunë nuk ka ndryshuar shumë. Ai thotë se “Në Prizren janë planet e njëjta që i kam parë para 5, 6 viteve. Askush nuk e merr parasysh rritjen, nëse ka ndojnë aktivitetet dhe ka nevojë për më shumë përkrahje; në komunë mendojnë vetëm për numrin e aktiviteteve që duhet të mbërrijnë. Askush nuk e bënë asnjë plan pak më të detajizim, mos të flasim për ndonjë strategji. Është njëfar pazari politik, na jemi në koalicion [partitë politike], edhe negociojnë me pozita të drejtorëve zakonisht me kulturë. Vjen ndërrohet një drejtor; drejtorin e kaluar të kulturës e kam taku njëherë apo dy, katër vitet e fundit.” Sipas drejtorit të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport “edhe pse nuk kanë strategji, ata vazhdimisht kanë takime me institucionet

e pavarura dhe përfaqësuesit e organizatave, dhe kështu ata i hartojnë politikat për kulturë”⁶⁸.

Në Pejë janë krijuar këshillat e ngjashëm që ishin paraparë në Strategjinë Orientuese të Kulturës për Komunën e Prizrenit. “Hapi i parë që e kam bërë, ka qenë krijimi i këshillave; me ndërtu këshillin e muzikantëve, këshillin e organizatave që merrën me aktivitete kulturore dhe bashkarisht me gjithë këta e kemi themelmu këshillin kulturor të Pejës”⁶⁹

Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport ne Pejë është deklaruar se duhet “me ndërtu një strategji për të ardhmën, duhet t’i marrim rekomandimet prej partnerëve. Partnerët janë OJQ-të e kulturës. Ne ende

68 Intervistë me Drejtor, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prizrenit, Prizren, gusht 2014.

69 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitat e Kosovës”, gusht 2014.

67 Forumi Kulturor, Forumi për Zhvillim Kulturor Raport mbi gjendjen ekzistuese në sektorin e kulturës, (Prizren: Forumi Kulturor, prill 2014).

nuk e dimë cilat janë kapacitet e organizatave. Nuk i kemi ende të qarta kapacitet financiare”. Por, megjithatë gjatë hulumtimit është kuptuar se ka bartës të institucioneve të pavarura relevante në Pejë, të cilat nuk kanë ndëgjuar për këto këshilla.⁷⁰

70 Intervistë me Vullnet Sanaja, Drejtor, Anibar, Pejë, gusht 2014.

KULTURA NË INVESTIMET KAPITALE

Mënyra se si vendoset dhe si menaxhohen investimet kapitale në komuna paraqet një indikator të qartë për politikat në kulturë në komuna. Në përgjithësi në nivel komunal investimet kapitale prej vitit 2007 janë rritë dukshëm. “Në vitin 2007 investimet kapitale përbënin diku rreth 17 përqind të shpenzimeve komunale, ndërsa në vitet në vazhdim shpenzimet kapitale rriten për të arritur mbi 50 përqind në vitin 2014.⁷¹ Edhe pse buxheti i komunave është shumë i ngjashëm me buxhetin e qeverisë qendrore ku investimet kapitale janë duke u rritë, sa i përket ndarjes buxhetore përkatësisht investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet mund të ndryshohën dhe propozohën nga kryetari i komunës “me kusht që asnjë shumë e këtille të mos bartet në një ndarje buxhetore për paga dhe mëditje pa miratimin e Ministrit dhe – sipas rastit

71 Dren Pozhegu për Forumi Kulturor, Politikat Kulturore dhe Ndarja Buxhetore për Kulturë në Kosovë, (Prishtinë: Forumi Kulturor, 2014).

– Qeverisë dhe Kuvendit”⁷²

Ligji për financat e pushtetit lokal, është me rëndësi edhe për sektorin e cultures, pasi që e siguron autonominë e plotë që komunat e kanë për ta rregulluar mënyrën se si e planifikojnë buxhetin vjetor. Sipas nenit 2.3 “Për të mirë të popullsisë së komunës, Kuvendi komunal dhe zyrtarët ekzekutiv kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t’i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm.”⁷³

Sot vija buxhetore me nivelin më të lartë të shpenzimeve ende mbeten investimet kapitale. Investimet kapitale sipas ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë janë prioritet. Sipas nenit 23 “pas miratimit nga kuvendi të një projek-

72 Ligji nr 03/ L-049, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.

73 Po aty.

ti kapital, Ministria dhe Kuvendi duhet t'ia kushtojnë prioritetin më të lartë të sigurimit të fondeve dhe ndarjes buxhetore të nevojshme për financimin e rregullt⁷⁴ kjo vlenë edhe për komunat pasi që në ligjin për financat e pushtetit lokal me nenin 7.2 të ligjit për financat lokale “7.2 Komunitat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPF gjatë disponimit me këto burime financiare.”⁷⁵

Investimet kapitale, siç është shprehur një ish-zyrtar komunal janë tepër të nevojshme për komunën. Një zyrtar tjetër komunal ka thënë ato “janë thembra e akilit” për komunën, edhe sa i përket investimeve në sektorin e kulturës.

Në Prizren “në 4-5 vitet e fundit, Komuna ka pasë vazhdimisht rreth 1 milion euro investime në infra-

74 Ligji nr 03/ L-048, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.

75 Ligji nr 03/ L-049, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.

strukturën kulturore. Në këto investime kanë hyrë edhe rehabilitimi i shtëpive të kulturës ekzistuese mandej meremetimet, ndërtimet e reja të qendrave kulturore sportive. Kjo ndoshta mundet me qenë mire, por ne e kemi një problem shumë të madh me çështjen e menaxhimit të këtyre hapësirave të reja. Me ndërtona e ndërtojm nuk ka kurrfarë problemi, e menaxhimi është pak më problematik. Njerëzit e rinj nuk mund të punohen sepse komuna nuk mundet me punësu staf të ri. Me i dhanë hapësirat në menaxhim dikujt osht shumë problematike”.

Në Prizren gjithashtu është raportuar nga EC ma Ndryshe se ka “një numër projektsh kapitale që janë financuar nga Komuna e Prizrenit me mjete të konsiderueshme nga buxheti komunal dhe se punimet nuk janë kryer si duhet as pas disa vitesh, pastaj objektet nuk janë funksionale, nuk përdoren për destinimin për të cilin janë planifikuar dhe ndërtuar, derisa ka edhe raste kur punimet e nisura kanë ngelë

pezull shkaku i planifikimit të pasaktë.”⁷⁶

Në Graçanicë po ashtu paraqitën probleme dhe situata të ngjashme “me qendren kulturore në Preoc, ku ne mbledhjen e më parshme, USAID, kontraktori pothuajse i ka imponuar komunës atë ndërtesë. Tash komuna i ka problemet e mirëmbajtjes së ndërtesës, fakturave. Thjeshtë kemi ardh deri te situata se kë ta angazhojme, sepse në qofte se e kemi ndërtesën si ndërtesë, asgjë nuk kemi fituar, në qofte se nuk është funksionale, në qofte se nuk ka përmbajtje, nëse diçka nuk bëhet.”⁷⁷

Drejtori i drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe sport të komunës së Graçanicës shtoi së “Këto nuk janë objekte në të cilat mund të organi-

76 EC Ma ndryshe, “Projektet kapitale me planifikim të dobët po e dëmtojnë buxhetin komunal,” Prizren, tetor 2014.

77 Intervistë me Dragan Dimitrijevic, Drejtor, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës, Graçanicë, gusht 2014.

zoni shfaqje, do të thotë ato janë objekte që kanë me qindra metra katror, apo të ndoshta më pak, thjeshtë mund të shfrytezohën për disa gjëra ashtu. Ne e kemi përafërsisht një strategji, që disa të rinj, të cilët janë të interesuar, t’i drejtojmë në secilen shtëpi të atyre ndërtesave, në mënyrë që t’a mendojmë planin që t’i ndihmojmë bashkësisë së komunës për atë se çfarë të bëjmë më tej, si përshembull shkollat e kurseve të kompjuterëve, shkollat e gjuhëve të huaja, diçka ashtu”⁷⁸

Këto probleme rrjedhin drejtpërdrejt nga fakti se këto investime të parasë publike bëhen në mungesë të strategjisë paraprake, se si të shpenzohën paratë publike apo siç thuhet në ligjin për vetqeverisje lokale për të mirë të popullsisë së komunës.

78 Intervistë me Dragan Dimitrijevic, Drejtor, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës, Graçanicë, gusht 2014.

Komuna dhe Institucionet e Pavarura të Kulturës

Institucionet e pavarura të kultures, në bazë të legjislacionit në fuqi, që mundëson ekzistencën e tyre, janë të regjistruara si “shoqata ose fondacione joqeveritare, jo-fitimprurëse që në misionin e tyre kanë edhe zhvillimin e veprimtarive kulturore.”⁷⁹ Edhe pse sipas legjislacionit në fuqi nuk ka institucion të pavarur të kulturës, institucionet e kulturës në komunat e përfshira në hulumtim paraqet rëndësi të madhe për shkak se implementojnë aktivitetet kryesore në këto komuna.

Zyrtarët në pyetjën të përshkruajnë mënyrën e hartimit të politikave të kulturës janë përgjigj se “bëhen në bazë të kërkesave për subvencione në fillim të vitit”, që do të thotë se e gjithë korpusi i hartimit të politikave në komuna bëhet në bazë të kërkesave të institucioneve të pavarura të kulturës. Në Prizren po ashtu ka kalendar të aktiviteteve, ku në të përfshihen edhe janë pjesa kryesore e aktiviteteve kulturore në

këtë komunë. “Tash kur te bëjmë planifikimin e shpenzimeve, na prej asaj shume parashohim për shembull festivale tradicionale, janë të listume krejt. Te aktivitetet kulturore. Po kryesisht, kryesisht janë organizata joqeveritare që janë benifituse të buxhetit.”

“Mua më vjen ma së keqi që Komuna nuk din me shfrytëzu punën që ne e bëjmë!” – Veton Nurkollari, drejtor artistik i DOKUFEST.

Sipas Nita Dedës, Menaxhere e Komunikimeve ne Dokufest “Skena njerëz që kanë eksperiencë në menaxhim të kulturës. Së nëse ke studio apo diçka të tillë atëherë ti dinë me ia ditë vlerën, një aktiviteti të caktuar, edhe e dinë që duhet ndoshta me mbështet ma shumë. E dinë qysh me bashkëpunu edhe me qu përpara, ish dashtë Dokufestin me u bo bashkë me qytetin”.⁸⁰

79 Ligji Nr.04/L-57 për Lirinë e Asociimit në OJQ, 12 Shkurt 2009.

80 Intervistë me Nita Deda, Menaxhere për Komunikim, Dokufest, Prizren, gusht 2014.

Në Pejë, Drejtori për kulturë, rini dhe sport po ashtu ka thënë se “duhet të ndërtohet një strategji për kulturë, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile” Megjithë këto zhvillime, në nivel komunal nuk është parë ndonjë nivel i hartimit të politikave strategjike sa i përket institucioneve të pavarura, edhe pse aktualisht këto institucione paraqesin pjesën kryesore të aktiviteteve kulturore në komunën e Prizrenit, Prishtinës dhe Pejës.

Komuna dhe Institucionet Publike të Kulturës

Institucionet publike të kulturës në nivel komunal, janë institucionet të cilat janë themeluar nga Komuna. Ligji për institucionet e Kulturës “ju ofron mundësi komunave në themelimin e institucioneve vendore, të cilat do merren me çështjet kulturore dhe artistike. Ligji i përcakton kriteret minimale për themelimin e institucioneve vendore. Vendimi, që ka të bëjë me themelimin e institucionit duhet t’i dërgohet Ministrisë së Kulturës”⁸¹

Ligji për institucionet e kulturës e rregullon që në nivel komunal, vetëm institucionet shtetërore kanë të drejtë në themelimin e institucioneve të kulturës. Ky ligj paraqet probleme dhe çështje në menaxhimin e këtyre institucioneve, pasi që, nuk sigurohët e drejta e tyre për veprim të pavarur. Sipas ligjit “Komuna është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së institucioneve kulturore që ajo i themelon dhe mund të ndalë akti-

vetetin e tyre.”⁸² Do të thotë në çdo moment komunat mund të vendosin të ndalë ekzistencën e ndonjë institucioni të kulturës.

Ligji për filharmoninë rregullon “themelimi, vazhdimësia, puna, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i institucioneve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit në Kosovë.” Institucioni i Filarmonisë, Operës dhe Baletit “themelohen dhe veprojnë si institucione publike dhe institucione private” edhe me këtë ligj nuk sigurohët pavarësia institucionale e filharmonisë në nivel lokal përderisa, ky institucion në këto kushte konsiderohët si institucion i komunës, prandaj komuna ka të drejtë të bëjë “Monitorimin e rregullt dhe mbikqyrjen e punës dhe të zbatimit të ligjshmërisë në nivel komunal, mbikqyrjen e bën drejtoria përkatëse e kulturës.”

81 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Doracak i ligjeve për komunat

82 Ligji nr 03/L-57, Ligji për institucionet e Kulturës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2007.

Teatrot rregullohen me ligj të veçantë, ku rregullohet edhe vendimarrja në teatër. Një indikator që ka të bëjë me mënyrën se si udhëhiqën teatrot gjindet në statutin e teatrit Dodona ku llogu e teatrit caktohet kështu:

- a) Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
- b) Rrethi i dytë: Komuna e Prishtinës;
- c) Rrethi i tretë: TQP “Dodona”;
- d) Në mes të vulës është emblema – logoja e Komunës”

Anëtarët e Këshillit drejtues të teatrit i emëron dhe i shkarkon Kryetari i Komunës

Anëtarët e Këshillit drejtues të teatrit i përgjigjen dhe i raportojnë Kryetarit të Komunës për punën e tyre;

Për shkak të kushteve të vështira financiare, teatrot nuk arrijnë të përmbushin edhe obligimet të cilat i ka caktuar ligji ku thuhet “Teatri i

qytetit mund të ketë ansamblin rezident prej së paku dhjetë (10) dhe me së shumti njëzet (20) aktorëve.” Sipas drejtorit të Tetarit Dodona, për shkak se mungojnë mjetet, dhe buxheti në tërësi për kundër faktit se Teatri Dodona bën punë shumë të madhe me kushtet që i ka, kjo është thyerje e ligjit të teatrit, pasi që nuk mund të punësojnë më shumë aktorë. Sipas ligjit “mjetet financiare për punën e teatrove të qyteteve i siguron komuna përkatëse.”⁸³ Po në të njejtën kohë, si problematike po ashtu shihet fakti se në këtë “në ligjin për teatër është neni 89 që thotë, të gjitha të më hershmet do të aplikohen varësisht prej Mundësisë financiare.” “Ligji për teatër, duhet me pasë një numër të caktume të ansamblit, që kaq premiera. Kur e sfidojsha ligjin në atë kohë, thojsha imagjinoni teatrin kombëtar të Kosovës, në ko-produksion me 12 teatro të Evropës pe bon një projekt I cili zgjat 6 vjet dhe i cili kushton 12 milion

83 Ligji për teatro

euro edhe e shtini teatrin kombëtar me thy ligjin. Në këtë rast nuk jam fans i numrave në kuptimin e sanksionimit. Ose një drejtor i bën pesë mbrëmje të poezisë edhe e shkruan në pllakat, shfaqje, shfaqje, edhe mund ta bëjë tik”⁸⁴

Për dallim nga niveli qendror, statutet e teatrove në nivel të qytetit, i miraton kuvendi komunal, me propozim të kryetarit të komunës, pasiqë ta harton këshilli drejtuës i teatrit. Ndërsa tashmë është inicuar edhe amandementimi i statutit të teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”, ku askush nga menaxhmeti aktual i Teatrit, përpos këshillit drejtuës, nuk është i përfshirë në këtë process. “Këtë është duke e kryer vetëm këshilli drejtuës në bashkëpunim me Komunën”⁸⁵, shprehet drejtori i Teatrit Dodona.

Në Graçanicë, rregullimi i institucioneve publike e cila përbëhet

84 Intervistë me Florent Mehmeti, Drejtor, Teatri ODA, prill 2014.

85 Intervistë me Agron Shala, Drejtor, Teatri Dodona, tetor 2014.

nga Shtëpia e Kulturës së Graçanicës, rregullohet në mënyrë shumë të posaqme pasiqë në të veprojnë punëtorë të Shtëpisë së Kulturës, që ishtë themeluar para 40-50 viteve dhe në kohën kur Graçanica ishte pjesë e Komunës së Prishtinës. Punëtorët e këtij institucioni pagat e tyre ende i marrin nga Qeveria e Sërbisë. Në ndërtesën e re të shtëpisë së Kulturës njëkohësisht veprojnë edhe punëtorët e Drejtoratit për Arsim, Kulturë, Rinisë dhe Sport të Komunës së Graçanicës. Në lidhje me këtë gjendje, menaxhimin e institucionit dhe dy sistemet fiskale dhe juridike që gjenden në të njëjtën ndërtesë Drejtori për Arsim, Drejtorisë për Kulturë në komunën e Graçanicës ka thënë “E dini se si, ajo gjë do të presë, mesiguri marrëveshjen politike në Bruksel e cila do të përfshije të gjitha departmentet”⁸⁶ Ai vazhdon duke thënë se “Për momen-

86 Intervistë me Dragan Dimitrjevic, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës, Graçanicë, gusht 2014.

tin është gjendja e cila funksionon mire, nuk kemi ndonje problem, e rezultatet janë të qarta, që për ne është me e rëndësishme.”⁸⁷ Komuna e Graçanicës për këtë institucion siguron shërbimet, rrymën, ujin do te thote, siguron që shtëpia e kulturës ti ketë kushtet normale teknike për punën e institucioneve.

Për shkak të marrëveshjes së Brukselit, kur kanë filluar t’i marrin kompetencat institucionet e Kosovës, të institucioneve të cilat deri në atë moment janë paguar nga qeveria serbe, institucionet e kulturës po ashtu janë në këtë proces, edhe pse transferimi i kompetencave është duke u bërë në mënyrë më të ngadalshme. Aktualisht, komuna e Graçanicës, e njeh drejtorin që vepron në shtëpi të kulturës “Po, sigurisht, që e njohim drejtorin, siç i kemi njohur të gjithë drejtorët e shkollave, drejtorët e shtëpive

të shëndetit, është rënë dakord edhe me Marrëveshjen e Brukselit, thjeshtë ashtu është situata siç edhe është krijuar, deri sa nuk të ndryshohet me një vendim politik.”⁸⁸

Sipas drejtorit të Shtëpisë së Kulturës, institucioni funksionon në mënyrë “Fantastike. Unë kam këtu njerëz të cilët ajo Komunë i ka punësuar ne Departamentin e vet të Kulturës. Ky është vendi i tyre i punës. Detyra ime është që unë atyre të ju gjej punë dhe t’i përfshijë në ndodhitë nga kultura, ata i kanë obligimet e tyre ndaj Komunës së Graçanicës, e kanë kordinatoren e cila është përgjegjëse për këta njerëz nga Komuna e Graçanicës, në bashkëpunim me mua, dhe ne funksionojmë të mënyrë të përsosur. Kjo është e kjo.”⁸⁹ Natyrisht, nëse, themi, ka ide dhe projekte

88 Intervistë me Dragan Dimitrijevic, Drejtor, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës, Graçanicë, gusht 2014.

89 Intervistë me Zika Rakocevic, Drejtor, Shtëpia e Kulturë, Graçanicë, gusht 2014.

87 Intervistë me Dragan Dimitrijevic, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës, Graçanicë, gusht 2014.

për njerëzit që i angazhon Komuna e Graçanicë, atëherë ashtu edhe realizohen. Ateherë, Departamenti i Kulturës i realizon këto projekte.”⁹⁰ Sipas tij Shtëpia e Kulturës është institucion i cili ka statut edhe punon në bazë të rregulloreve të cilat sistematizojnë dhe dhe përshkruajnë detyrat e secilit punëtorë.

Institucionet publike në nivel komunal në Pejë, paraqitën në organogramin e komunës. Sipas drejtorit aktual të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Pejë “Galeria punojnë në bazë të një kalendari politik, ta quajmë, siç është dita e pavarësisë, dita e çlirimit. Në nderim të këtyre ditëve hapet një ekspozitë. Që nuk është në funksionimin e mirëfilltë të Galerisë, sepse Galeria duhet ta ketë një marrëdhënie të ndërtuar me artist edhe në vend edhe jashtë vendit, edhe ditëve kur ata kishin mujt me ardhë me ekspozu.”⁹¹ Ai

vazhdoi duke thënë se “Nuk ka një plan program, nuk e ka një axhendë të vetën. Unë e shoh këtë që ndodh për dy arsye, në mungesë të resurseve njerëzore të mjaftueshme. Ne e kemi vetëm një drejtor, është një artist i mrekullshëm por është i vetmuardhe nuk ka buxhet”. Galeria e arteve në Pejë, si institucion publik nën DKRS të Pejës gjithashtu mund të ketë hapësirë edhe për ndonjë ekspozitë e cila nuk është planifikuar në fillim të vitit, nëse komuna kërkon diçka të tillë, dhe nëse ka hapësirë në mes të ekspozitave. Në Pejë, sa i përket ndikimit të nivelit ekzekutiv të qeverisjes në teatër mund të vërhet me shkarkimin e më hershëm të këshillit drejtuës të teatrit të Pejës “Është shkarku me iniciativën e kryetarit të komunës edhe natyrisht me drejtorin e kulturës, por komuniteti artistik është mbledhë edhe ata e kanë zgjedhë këtë bordin e ri. Këtë

90 Intervistë me Zika Rakocevic, Drejtor, Shtëpia e Kulturës, Graçanicë, gusht 2014.

91 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës,

në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

bord tjetër e ka aprovu kryetari.”⁹²

Në Prizren, teatri i Prizrenit nuk ka këshill, sipas drejtorit aktual, i vetmi i punësuar në teatër për momentin mendon se është bërë shkelje e ligjit “Sigurisht që shkruan, janë aty pikat, nenet që teatrot publike të qytetit duhet patejetër të kenë një këshill drejtues. Duhet të ketë një drejtor artistik, edhe këto nuk janë tu funksionu në teatrin e Prizrenit, deri tani nuk kanë funksionu.”⁹³ Sipas drejtorit të teatrit “komuna është e obligume me i kry këto gjana, janë në kompetencë të komunës këto. Domethënë prej momentit që është ba memorandumi, të gjitha i ka komuna. Edhe konkursin për drejtor e organizon komuna.”

“Praktikisht me këtë kornizë ligjore njëfarë mënyrë është tejkalu fakti që teatri para se të jetë

92 Interviste me Nimon Muçaj, Drejtor, Teatri i Qytetit të Pejës, Pejë, gusht 2014.

93 Intervistë me Fetah Pacarizi, Drejtor, Teatri i Qytetit të Prizrenit, Prizren, gusht 2014.

një institucion publik me karakter menaxhues, është një institucion me karakter artistik. Nuk ka pasë konisderatë fare për faktin që ky teatër, jo vetëm teatri kombëtar, por i gjithë rrjeti i teatrove publike të Kosovës, para së gjithash duhet të drejtohet nga premisa artistike, dhe si e tillë ato duhet të kenë në krye të tyre një autoritet kredibil në fushën e teatrit. Kjo gjendje e krijuar nga Ministria e Kulturës dhe kryetarët e komunave, ka prodhu defekte në jetën e madhe teatrore, praktikisht teatrot e qyteteve janë të paralizuara, nuk funksionojnë gati fare në mungesë të mjeteve buxhetoree, për shkak se kryetarët e komunavenuk e dinë rëndësinë e artit dhe për këtë arsye nuk ndajnë fonde për, ndonëse ligji e thotë se ato duhet të ndajnë fonde dhe komunat janë të detyruar të ndajnë fonde për këto teatro. Për shkak se nuk i ndajnë ato mjete, edhe jeta e teatrove krijuese nëpër qytete është paralizuar, pikërisht për shkak të atyre mjeteve dhe për shkak

të këtyre korniza ligjore e cila i ka privu që teatrot të marrin buxhet drejtpërdrejt nga Ministria e Kulturës, përveç një pakoje prej 10,000 euro që atyne ju ndahet në kuadër të këtij konkursi për promovim kur iu ndahen edhe OJQ-ve edhe rrjetit të pavarur gjë që është paradoksale sepse në këtë konkurs përzihën edhe institucionet publike.”⁹⁴

Në Prizren më herët është bërë, pavarësimi i një institucioni publik. Shtëpia e Kulturës së Prizrenit, nuk është më nën menaxhimin e Komunës. Por “drejtuesit e shtëpisë së kulturës “Xhemajli Berisha” në Prizren kanë kërkuar nga Kuvendi Komunal që ky institucion të kthehet nën ombrellën e pushtetit lokal, siç ka qenë para vitit 2007, pasi që aktualisht ndodhet në pozitë të vështirë financiare. Brenda mundësive ligjore, nëse ka pak hapësirë të kthehet në gjendjen e mëparshme statusi juridik i këtij institucioni kul-

94 Intervistë me Bekim Lumi, Regjisor/ Profesor, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, prill 2014.

turor, që nënkupton futjen e tij nën menaxhimin e tërësishëm të KK-së”, thuhet në shkresën e Drejtorit të Shtëpisë së Kulturës Arben Rashkajt, të publikuar nga gazeta Koha Ditore.⁹⁵

Për shkak të vështirësive me Shtëpinë e Kulturës, edhe për shkak se këtë hapësirë e shfrytëzon Teatri i Prizrenit, janë shkaktuar edhe shumë problem në zhvillimin e aktiviteteve të kulturës në këtë hapësirë “nuk ki gjasa me shku në Prizren, na i kemi reduktuar vizitat në teatër të Prizrenit për shkak të se ai kërkon qira për hapësinën. Ti e qon një produkt atje, i pagun krejt shpezimet, edhe duhësh me pagu qiranë sepse drejtori i Shtëpisë së Kulturës na kështu i fitojmë rrogat. Do të thotë ti ske partner”⁹⁶.

95 Koha net, “Shtëpia e Kulturës në Prizren s’mund të mbijetojë me vetëfinancim,” Koha net, 17 shtator 2014 (qasur në shtator 2014)

96 Intervistë me Jeton Neziraj, Drejtor, Qendra Multimedia, Prishtinë, prill 2014.

QASJA NË VENDIMARRJE

Në këtë pjesë të raportit analizohët pozita e institucioneve të kulturës sa i përket përfshirjes së tyre në vendimarrje. Qasja në vendimarrje “e bën të mundshme pjesëmarrjen e vazhdueshme qytetare në procesin politik dhe i kontribuon punës së hapur dhe transparente të pushtetit ekzekutiv dhe përfaqësues.”⁹⁷

Me rregullimin ligjor të tanishëm për institucionet komunale, distanca e pushtetit, në këtë rast institucioneve të pavaruara të kulturës dhe qytetarit dhe komunave është e madhe. Edhe pse përfshirja e grupeve të interesit dhe qytetarëve në vendimarrje garantohet nga ligji për Vetqeverisje Lokale. Mekanizmat e demokracisë së drejtpërdrejt, të paraqitura në Kreun IX Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve.”⁹⁸ janë e vetmja bazë

97 Eszter Hartay për KCSF, Pjesëmarrja Qytetare Praktikrat më të mira në Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimin Europian, (Prishtinë: KCSF, 2011), f.4.

98 Këto mekanizma janë inkorporuar edhe në Statutet e komunës së Prishtinës,

ligjore përmes së cilës mund të marrin pjesë qytetarët në vendimarrje. Mekanizmat përmes këtij ligji shpërfaqën në: Informimi Publik dhe Konsultimi, Peticioni, Iniciativa Qytetare, Referendumi, Largimi i kryetarit, Komiteti Konsultativ.⁹⁹

Zgjidhjet si Iniciativa Qytetare, Referendumi, dhe Peticioni mundësojnë që qytetarët me anë të disa procedurave të kenë të drejtë të nisin inciativa legjislativë në kuvende komunale në mënyrë që të diskutohen në kuvend komunal. Përmes Iniciativës qytetare, drafti i rregullores duhet të nënshkruhet nga 15% e votueseve të regjistruar në Komunë. Ndërsa themelimi i komiteteve Konsultative si zgjidhje ligjore është mënyra më e qëndrueshme dhe e përshtatshme përmes së cilës mund të gjejnë hapësirë të inkuadrohen institucionet e pavarura të kulturës

Prizrenit, Pejës, Graçanicës.

99 Komuna e Prishtinës, Vendim për themelimin e komitetit konsultativ, vendimi 01 nr.110 – 76408, 31.3. 2014.

dhe grupet e interesit të sektorit të kulturës. Ligji për Vetqeverisje lokale obligon që komunat të krijojnë komitete konsultative me pjesëmarrje nga organizatat jo qeveritare dhe qytetarët. Anëtarët e këtyre komiteteve, mund të “dorëzojnë propozime, kryejnë hulumtime, dhe të ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit”¹⁰⁰

Komitetet këshilldhënëse sektoriale kanë potencial të bëjnë pjesë të vendimmarrjes në legjislativ grupet e interesit për sektorin e kulturës. Sipas ligjit kuvendi i komunës mund të themelon komitete këshilldhënëse sektoriale “me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimarrjes.”¹⁰¹. Ky ligj nuk e kufizon numrin e komiteteve konsultative dhe mund të jetë një mënyrë efektive ku qytetarët dhe grupet e interesit të kulturës mund

100 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovë, 20 shkurt 2008.

101 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovë, 20 shkurt 2008.

të ndikojnë në kulturë.

Mirëpo aktualisht, sa i përket komiteteve në Prishtinë, sipas Statutit themelohet nga Kuvendi i Komunës, “pas propozimit të kryetarit të komunës, komitetet e përhershme dhe nga grupi i qytetarëve”¹⁰² në të njejtën kohë, në Prishtinë mund të themelohen komitete konsultative ad hoc. Këtë vit në komunën e Prishtinës, konform udhëzimit administrative 2008/10 për Organizimin dhe Themelimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, është marrë vendim nga kuvendi komunal që të shpallet konkurs publik për themelimin e komitetit konsultativ. Është përzgjedh një komision nga rradhët e anëtarëve të kuvendit komunal, për të bërë shpalljen, përzgjedhjen dhe kriteret nga anëtarët e kuvendit komunal.¹⁰³

102 Komuna e Prishtinës, Statuti I Komunës së Prishtinës, (Prishtinë: Komuna e Prishtinës, 2010).

103 Vendim për themelimin

Në statutin e Prizrenit, Komitete Këshilldhënëse nuk paraqitën si obligim ligjor, por rregullohen duke i dhënë kuvendit të komunës të drejtë që “në çdo kohë, sipas nevojës mund të themelojë edhe komitete këshilldhënëse nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes”¹⁰⁴ “Deri tani, komuna e Prizrenit është treguar shumë e ngathtë në themelimin e komiteteve konsultative. Në të njëjtën kohë, nuk është vërejtur as ndonjë interesim nga qytetarët ose shoqëria civile për të shfrytëzuar këtë mekanizëm të vendimmarrjes qytetare”¹⁰⁵

Në Pejë, statuti nuk e paraqet themelimin e komitetit konsultativ

104 Komuna e Prizrenit, Statuti i Komunës – Prizren, (Prizren: Komuna e Prizrenit, 2008) [https://kk.rksgov.net/prizren/Kuvendi-\(1\)/Statut.aspx](https://kk.rksgov.net/prizren/Kuvendi-(1)/Statut.aspx)

105 Online Transparency “Qasja e Qytetarëve në Vendimmarrje” <http://www.online-transparency.org/?page=1,30> (qasur me Shtator 2014)

si obligim ligjor, i cili është edhe i pajisur me udhëzim administrative. Në statut thuhet se “kuvendi Komunal mund të krijoj komitete këshilldhënëse sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.” Po ashtu statuti shpërputhet me udhëzimin administrative kur thotë se kuvendi komunal do të emëroj anëtarët e komiteteve konsultative, ndërsa në udhëzim administrative kjo pjesë e anëtarësisë rregullohet “përmes shpalljes publike.”¹⁰⁶ Në Pejë po ashtu me statut në rast të themelimit të komiteteve garantojë balance gjinore, dhe i komiteteteve ekzistuese dhe po ashtu të fshatrave.¹⁰⁷ Për momentin në Pejë nuk është themeluar asnjë komitet konsultativ.

Sipas Statuti të Kuvendit komunal të Graçanicës komitetet konsul-

106 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzimi Administrativ nr 2008/10 për organizimin dhe funksionimin e komiteteve në Komunë, 15 korrik 2008.

107 Komuna e Pejës, Statuti i Komunës së Pejës (Pejë: Komuna e Pejës, 2008).

tative duhet të përfaqësojnë sektorët e ndryshëm të shoqërisë dhe të ketë balance gjinor dhe etnik. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve përcaktohet me rregullore. Një rregullore e tillë nuk mund të gjindët ne ëbfaqe të Komunës së Graçanicës. Mos themelimi i këtyre komiteteve konsultative nga këto tri komuna paraqet një shkelje të ligjit të vetqeverisjes lokale.

Gjatë hulumtimit nuk është identifikuar ndonjë praktikë apo dokument strategjik e cila kish me i përmbush kriteret si politik e kulturës, dhe e cila udhëheq punën e drejtorisë për kulturë, ku obligohën të krijojnë hapësirë për qytetarët apo institucionet e kulturës që të jenë pjesëmarrës. Të gjitha zgjidhjet të cilat janë identifikuar në komuna, dhe për të cilat kanë treguar zyratarët e komunal, janë zgjidhje ad hoc dhe nuk janë rutinë në kalendarin e punës së një komunës për të funksionuar dhe nuk paraqesin zgjidhje apo politika të qëndrueshme por janë vendime afatshkurtë, të

cilat mund të shuhën në çdo moment, dhe janë përjashtime në funksionimin e komunave.

Në Komunën e Pejës, me iniciativë të Drejtorit për Kulturë, Rini dhe Sport mendon se “bashkëpunimi mes komunës dhe shoqërisë civile në përgjithësi është i mirë, dhe nuk merrët asnjë vendim pa u konsultu shoqëria civile” si shembull të tillë drejtori ka treguar se “Zgjedhja e këshillit drejtuës të teatrit, është e drejtë ekzkluzive e kryetarit të i emëroj. Kurse në Pejë ka ndodh që kryetari të mos jetë fare aty. Janë ftu të gjithë aktorët e Pejës dhe është mbajt kuvend zgjedhor.”¹⁰⁸

Këtë vit sa i përket qasjes në vendimarrje drejtori për kulturë, rini dhe sport i Pejës mendon se kanë arritë mjaft mirë me identifikuar situatën “përafërsisht e kemi numrin e organizatave që veprojnë në kulturë dhe

108 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

individëve dhe llojet e kulturës. Unë një strategji vetëm prej Departamentit të kulturës nuk mundet me u përpilu. OJQ-të duhet me marrë një përgjegjësi të madhe, edhe mandej duhet me i kordinu, edhe me i marrë për bazë edhe mundësitë që i kemi në terren, edhe ta bëjmë një strategji të mirë”¹⁰⁹.

Sipas drejtorit ekzekutiv të Festivalit Anibar Vullnet Sanaja, tregon se takime formale me komunën kanë pasë dy apo tri herë, ndërsa takime jo formale për ndonjë kërkesë me të vogël ka qenë shumë më e shpeshtë, për shkaqe burokratike. Por ai shtoi se “na prap nuk e gjykojmë, nuk jemi shumë të ashpër në gjykimin e qeverisjës së tanishme, sepse tani janë vetëm qe 7 muaj si qeverisje lokale. Që ishin dasht me qenë shumë si shtatë muaj, por gjërt për të cilat po flasim kërkojnë

më shumë kohë.”¹¹⁰

Përndryshe punëtorët e kulturës të pavarur tregojnë se takime kanë pasë “disa herë me drejtorin ne lidhje me projektet që mund ti financoj komuna” por nuk kanë pasë takime formale “në lidhje me hartimin e politikave të caktuara në komunë.”

Në Prizren, avokimi nuk funksionon, sipas drejtorit të dokufestit, nuk kanë mbërri me ndryshu asgjë, dhe se vetëm thirrën nëpër dëgjime publike. Veton Nurkollari, Drejtori i Dokufest thotë se “e krijuam rrjetin, na po tentojmë pak me kriju ndonjë trysni, thjesht na injorojnë. Nuk e marrin si diçka serioze, na marrin si një grup që jeni mbledh edhe nuk ju intereson. Nuk ka vullnet të mirë, qajo po më vjen keq, sepse nuk po shndërrohet kjo në njëfarë vullneti të mirë që me pasë mundësi me qenë ma mire.”¹¹¹

109 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

110 Intervistë me V.S.

111 Intervistë me Veton Nurkollari, Drejtor, Dokufest, Prizren, gusht 2014.

Sa i përket qasjes në vendimarrje për herë të pare, Komuna e Prishtinës ka formuar komisionin për vlerësimin e subvencioneve me anëtarë të jashtëm, të propozuar nga drejtoria për kulturë, rini dhe sport dhe të zgjedhur nga Kryetari i komunës. Më herët në Prishtinë, nuk ka pas një zgjidhje të tillë për përfshirjen e grupeve të interesit, apo njerëzve të fushës në vendimarrje.¹¹² Por edhe pse me vendimin e ri përfshihët shoqëria civile në këtë proces njerëzit të cilët marrin pjesë në këto komisione zgjedhën nga kryetari i komunës.

Në Graçanicë sa i përket vendimarrjes, nuk ka komisione të cilat janë të përbëra nga anëtarët e jashtëm. Drejtori thekson se nuk “kanë resource për ta bërë këtë”. Mirëpo, me qeverisjen e re punëtorët nga institucionet e pavarura janë shprehur se “kanë bashkëpunim shumë më të mirë me kryetarin e ri të ko-

112 Intervistë me Blerta Zeqiri, Drejtore, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës, Prishtinë, prill 2014.

munës”.¹¹³ Në pyetjen sa a janë këto takime zyrtare, është shprehur se “kanë pasë takime, por është ende qeverisje e re dhe se tash e tutje planet dhe idetë për kulturë që i kanë mund të shprehin dhe mund të gjejnë përkrahje nga komuna e Graçanicës.”¹¹⁴

Gjithashtu janë shprehur se raport zyrtar me Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport nuk kanë, për shkak se ka mundësi të komunikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt me kryetarin e komunës. Një komunikim të tillë drejtori i AKC, nuk e ka pasë me ish-kryetarin e komunës së Graçanicës apo me ndonjë zyrtar të komunës.

Nëse e kemi parasysh që vendimarrja në këtë komunë, por edhe në Komunën e Pejës, bashkë me buxhetin e subvencioneve, është bartur krejtësisht në zyrën e kryetarit

113 Intervistë me, Drejtor, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria Graçanicë, Graçanicë, gusht 2014.

114 Intervistë me Nenad Maksinovic, Drejtor, AKC center, gusht 2014.

të komunës, drejtorati për arsim, Kulturë, Rin dhe Sport nuk ka buxhet për kulturën kjo është mënyra e vetme e komunikimit me autoritete lokale përgjegjëse. Sa i takon institucioneve publike, nuk janë identifikuar mekanizma të posaqëm të cilat mund ti përdorin institucionet publike të kulturës në mënyrë që të kenë qasje në vendimarrje. Pas që komunikimi zyrtar i institucioneve publike me komunën bëhet përmes raportimeve të rregullta të këtyre institucioneve në drejtoratet e komunave nga të cilat ato si institucione ligjërishjt janë të varura. Komunitat janë edhe punëdhënësi i punëtorëve të këtyre institucioneve. Sipas Ligjit për Teatrot “teatrot duhet të raportojnë çdo vit tek kryetari i komunës.”¹¹⁵

115 Ligji ne 04/ L-106, Ligji për teatro, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2010.

QASJA NË RESURSET PUBLIKE

	Prishtinë	Pejë
Buxheti i Përgjithshëm	63,443,190	19,087,594
Subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport	350,000	0
Investimet kapitale për Kulturë, Rini dhe Sport	2,735,000	180,000

Tabela 2.0: Buxheti i Komunave për Kulturë në vitin 2014

Shpërndarja e resurseve publike të nivelit komunal për institucionet e pavarura të kulturës, është indikatorë që tregojnë pozitën e këtyre institucioneve karshi komunave përkatëse. Komunitat sipas Ligjit për Vetëqeverisje lokale e kanë kompetencë vetanake kulturore. Kjo pjesë e raportit paraqet dy nivele të marrëdhënieve në mes të institucioneve të pavarura dhe komunave, përkatësisht qasjen që institucionet e pavarura të kulturës e kanë në resurset financiare publike dhe qasjen në shfrytëzimin e pronave komunale për zhvillimin e veprimtarisë kulturore. Në këtë

pjesë të raportit do të analizohen këto dy aspekte kryesore të alokimit të resurseve publike:

Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Ligji për financat e pushtetit lokal, rregullon financat e komunave dhe mënyrën e shpërndarjes së buxhetit. Sipas nenit 7 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, burimet financiare komunale janë “të hyrat vetanake; grantet operative; grantet për kompetencat e shtuara; transferet për kompetencat e deleguara; grantet e jashtëzakonshme; ndihma financiare nga Republika e Serbisë, dhe të hyrat nga huamarrjet e komunës. Ndërsa lidhshmëria e këtyre dy ligjeve paraqitet në nenin 7.2 “Komunitat

duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë disponimit me këto burime financiare.”¹¹⁶

Ndërsa sipas 30.6 Kufizimet e parapara në LMFPP për dhënien e granteve, dhuratave, donacioneve ose subvencioneve për cilindo person ose ndërmarrje zbatohen për komunat, komunave po ashtu iu është centralizuar buxheti tek kryetari i komunës.

“Buxheti në qeverisjen lokale paraqet planin financiar, i cili specifikon të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore. Përmes procesit buxhetor, institucionet në nivel lokal vlerësojnë nevojat e tyre kundrejt nivelit të buxhetit që kanë në dispozicion. Në kuadër të buxhetit komunal përfshihet buxheti operacionaal dhe kapital. Buxheti operacional përfshinë planin aktual të shpenzimeve dhe mënyrën se si do të mbulohen ato

shpenzime. Në anën tjetër buxheti kapital përfshinë planin afatgjatë të shpenzimeve për blerjen e aseteve dhe mënyrën se si ato shpenzime do të mbulohen.”¹¹⁷

Resurset publike të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me veprimtari kulturore shfaqën në dy forma, Buxheti Publik ndahët në 1. Subvencione 2. Investime Kapitale 3. Mallra dhe Shërbime 4. Paga dhe Mëditje. “Buxheti për subvencione dhe investime kapitale – si dy linja buxhetore të ndara direkt për aktivitete kulturore në vend se të jene për burokracinë institucionale siç është rasti me pagat dhe mëditjet, shërbimet komunale apo mallrat dhe shërbimet – si përqindje e buxhetit të DKRS-se për atë komunë.”¹¹⁸

117 Instituti për Studime të Avancuara Gap, Praktikat e Buxhetimit në Gjashtë Komuna të Kosovës, (Prishtinë: Instituti Gap, 2014).

118 Dren Pozhegu për Forumi Kulturor, Politikat Kulturore dhe Ndarja Buxhetore për Kulturë në Kosovë, (Prishtinë: Forumi Kulturor, 2014).

116 Ligji nr 03/ L-040, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 20 shkurt 2008.

Shpërndarja e Buxhetit për Institucionet e Pavarua

Buxheti i Komunave i cili mund të alokohet drejtpërdrejt për veprimtari kulturore bëhet përmes vijës së subvencioneve. Sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal, subvencionet menaxhohen sipas rregullimit të subvencioneve në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Në nenin 30.6 thuhet “Kufizimet e parapara në LMFP për dhënien e granteve, dhuratave, donacioneve ose subvencioneve për cilindo person ose ndërmarrje zbatohen për komunat”¹¹⁹ Ndërsa, në këtë ligj ku rregullohen subvencionet, sipas nenit 53.3 “Ministri është shprehimisht i autorizuar që të nxjerrë rregullat të cilat duhet të respektohen nga organizatat buxhetore ose autoritetet publike gjatë përzgjedhjes së pranuesit ose pranuesve si dhe përcaktimit të shumës ose shumave të cilat do të epen në formë të grantit, donacionit ose subvencionit. Këto rregulla duhet të sigurojnë që procesi të ketë për qëll-

¹¹⁹ Ligji nr 03/ L-049, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.

lim arritjen e synimeve të Kuvendit kur i njëjti e ka autorizuar grantin, donacionin ose subvencionin përkatës në ligjin përkatës për ndarjet buxhetore.”¹²⁰

Kështu të gjitha fondet publike për kulturën që shpërndahen si subvencione, për administrimin e tyre, në këtë rast komunat bazohen në tri nenet e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Ligji aktual e centralizon vendim-marrjen për subvencionet tek kryetarët e komunave. Sipas këtyre neneve ministrat ose në këtë rast kryetarët e komunave janë të autorizuar t’i krijojnë edhe rregullat e këtij procesi. Në disa komuna kjo do të thotë që një buxhet vjetor ndahet drejtorive përkatëse, dhe këto drejtori mund të menaxhojnë se si e shpërndajnë atë buxhet.

Mirëpo në komunën e Pejës dhe Graçanicës, ky buxhet ende mbetet 120 Ligji nr 03/ L- 048 , Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Kuvendi I republikës së Kosovës, 2008.

tejet i centralizuar, duke u menaxhuar nga vetë kryetarët e komunave. Sipas drejtorit për Kulturë, Rini dhe Sport në Pejë “Buxheti për kulturë, Rini dhe Sport është zero, nuk ka buxhet. Ka buxhet për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Mallra dhe shërbime nënkuptohet aktivitet Brenda zyrës, si faktura që ne i harxhojmë vazhdimisht.”¹²¹ ndërsa në Prishtinë dhe në Prizren, kryetari e nënshkruan vendimin në fund por buxheti për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit alokohet në fillim të vitit.

Rrjedhimisht me këtë ligj kryetarët e komunave kanë autonomi të plotë sipas legjislacionit në fuqi, të administrojnë buxhetin i cili parimisht do duhej të ishte gjithpërfshirës dhe transparent. Mirëpo duke u bazuar në këtë ligj, kryetarët e komunave duhet të rregullojnë adminis-

trimin e buxhetit. Ndërsa edhe pse kryetarët apo ministrat obligohen që të vëjnë rregullat, ky nen në ligjin për menaxhimin e financave publike lokale, ka krijuar hapësirë për interpretime dhe rregullime ad hoc nëpër komuna, të cilat nuk paraqesin politika strategjike të kulturës.

Në këtë nivel vendimmarrja është e centralizuar të Kryetarët e Komunave. Por për dallim prej Ministrive në të cilat subvencionet ende administrohen pa rregullore të veçanta, disa komuna kanë krijuar rregullore për administrimin e subvencioneve të cilat janë aprovuar nga Kuvendët Komunale apo janë rregulluar përmes ndonjë vendimi të kryetarit të komunës. Disa prej tyre janë publike edhe mund të gjenden edhe në ëeb faqet e Komunave. Edhe pse këto rregullore, pa përjashtim nuk paraqesin ndonjë politikë apo strategji të kulturës, këto i vendosin kriteret bazike për dhënien e subvencioneve.

121 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

Pozita e institucioneve të pavarura në buxhet në nivel lokal vërhet duke l analizuar se si janë vendos të shpërndahen subvencionet, për shkak se në linjat tjera buxhetore këto institucione pos me disa përjashtime nuk kanë qasje. Që do të thotë se edhe në nivel komunal, sikurse në atë qendror, institucionet e pavarura mund të përkrahën në bazë të projekteve, dhe nuk ka mekanizma të qëndrueshëm për financimin e projekteve dhe produktionit të tyre.

Në Prishtinë, dikur “Komuna e Prishtinës ka funksionu si mkr s e vogël, e njejta burokraci, i njëjti njejti komplikim, vetëm buxheti i vogël. Skemi pasë kurrfarë komunikimi zyrtar.”¹²² Deri rreth gjysmës së vitit 2014 nuk ka pasë konkurs të hapur për financimin e projekteve të kulturës. “Ka pasë mundësi, secili institucion në çdo kohë, të konkuroj”.

122 Intervistë me Jeton Neziraj, Drejtor, Qendra Multimedia, Prishtinë, Maj 2014.

Tashmë, në vitin 2014 në webfaqe të komunës së Prishtinës mund të gjenden udhëzime për aplikim për financimin e projekteve të veçanta. Kriteret bazë për ndarjën e subvencioneve janë caktuar me vendim të kryetarit të komunës, por në Prishtinë nuk ekziston një rregullore e aprovuar nga Kuvendi komunal për ndarjën e subvencioneve. Në dy vendimet të kryetarit të komunës së Prishtinës, fillimisht në vitin 2012, të nënshkruar nga Isa Mustafa, dhe pastaj në vendimin për caktimin e kriterëve për subvencione të vitit 2014, nuk ka dallime të skajshme.

Dallimi i vetëm që mund të vërehët është tek caktimi i komisionit, më saktësisht neni 10 ku në vendimin e fundit thuhët “Kryetari cakton komisionet për ndarjën e subvencioneve, sipas fushave. Komisionet janë në përbërje të 5 anëtarëve. Anëtarët e komisionit janë nga drejtorja, ekspert dhe shoqëria civile”¹²³ Për herë të parë shihët në një

123 Komuna e Prishtinës, Kryetari i Komunës, Vendim për kriteret dhe

vendim që rregullon subvencionet, fjala shoqëria civile. Megjithatë, komisioni i jashtëm është propozuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa vendimi final për përbërjen anëtarëve të komisionit ka qendëruar tek kryetari i komunës. Komisioni ka qenë i përbërë nga 3 anëtarë të jashtëm, Drejtorëshën për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe kordinatorën për kulturë. Ndërsa për caktimin e komisioneve në vendimin e vjetër thuhej “kryetari i komunës i cakton komisionet për ndarjen e subvencioneve sipas fushave, për të cilat ndahen subvencionet”¹²⁴

Për herë të parë në 2014 hera e parë që në një proces të tillë të vendimmarjes kanë marrë pjesë grupe të interesit dhe profesionistë të fushës. Komuna e Prishtinës këtë vit ka bërë publik edhe votimin e Komis-procedurën e Ndarjës së Subvencioneve, 12.5.2014.

124 Komuna e Prishtinës, Kryetari i Komunës, Vendim për kriteret dhe procedurën e ndarkës së subvencioneve, 19.10.2012.

ionit. Kriteret në sektorin e kulturës mbesin të njëjta, edhe në vendimin e ri për rregullimin e kriterëve të subvencioneve përshembull, në të dy vendimet thuhet se prioritet për përkrahje sa l përket arteve pamore kanë “kornizat për piktura dhe botimi i katalogëve”

Edhe pse është themeluar komisioni i jashtëm për vlerësimin e projekteve të aplikuesëve, vendimi përfundimtar edhe në këtë rast ka mbet tek vullneti i kryetarit të komunës. Kryetari i komunës ka të drejtë edhe të ndryshoj përfundimisht vendimet apo vlerësimet e komisionit, edhe pse përmes intervistave është kuptuar se kjo gjë nuk ka ndodh.

Sa i përket subvencioneve, në Komunën e Prishtinës, artistët individual, institucionet e pavarura, institucionet publike, kompanitë private mund të aplikojnë gjatë gjithë vitit, mirëpo vlersimet e projekteve nga komisionet e ndryshme ndodh çdo

tre muaj.¹²⁵

Në komunën e Prishtinës është bërë tentim për të bërë ndarjen e buxhetit publik në mënyrë më transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke publikuar rezultatet, duke arsyetuar projektet e refuzuara si dhe duke themeluar komisione të jashtme – të cilat kanë përbërje të ndryshme në secilën fazë. Zyrtarët e komunës kanë thënë se tani e tutje duan ta rregullojnë “Vizioni i jonë, sa i përket subvencioneve është që duhet me pasë konkurs një vjeçarë për projekte, të cilat mundën me u planifiku ma herët. Me qenë njëfarë konkursi njëherë në vjet – kjo kish me qenë idealja. Edhe me lon prap se prap këtë pjesën e subvecioneve çdo tre muaj... pork jo me vlej të për projekte kulturore apo sportive të rinisë” është shprehur drejtoresha aktuale për kulturë, rini dhe sport

125 Komuna e Prishtinës, “Forma për aplikim” <https://kk.rksgov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit/Forma-per-aplikim.aspx> (qasur me shtator 2014).

Blerta Zeqiri.

Në Prizren është hartuar rregullorja për ndarjen e subvencioneve në prill të 2013. Në bazë të kësaj rregullore e cila është e destinuar për të gjitha drejtoritë të cilat mund të ndajnë subvencione, pjesa e rregullorës që rregullon veprimtarinë për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk është specifike dhe nuk vendos kritere të cilat mund të matën me indikatorë konkret. Në pjesën e rregullores që merrët me “subvencionimi i pjesëshëm i festivalet të muzikës dhe filmit” bazohet në “projektin e manifestimit; rëndësinë e manifestimit; traditën e manifestimit; nivelit e organizimit të manifestimit; kohëzgjatjen; dhe numri i anëtarëve në kuadër të manifestimit”¹²⁶

Këto kritere nuk janë specifike, dhe lihen në interpretimin e komisionit të brendshëm apo përkatësisht

126 Komuna e Prizrenit, Rregullore për ndarjen e Subvencioneve (Prizren: Komuna e Prizrenit, 2013).

bordit të drejtorëve të vendosin secilën herë, dhe si të tilla nuk paraqesin ndonjë mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse në të cilat institucionet e kulturës e kishin synuar, apo e kishin pasë një ide më të qartë se çfarë lloji të përkrahjes mund të presin nga Komuna. Në Prizren nuk ka një dokument e cila i bën më të qartë apo paraqet indikatorë konkret në bazë të cilave ishte kriju mundësia që komisionet si dhe institucionet e kulturës ti i vlerësojnë këto projekte.

Kështu, gjatë procesit hulumtues, për ta kuptuar se si shpërndahen dhe si mund t'i përkthejnë këto kritere në indikatorë konkret drejtori i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Prizrenit ka thënë se është numri i vizitorëve, apo tradita “festival tradicional mund të jetë një festival që funksionon në Prizren më shumë se dy vite”¹²⁷ Këtë vit idetë e reja nuk janë

përkrah për ngjarje edhe për shkak se kryetari ju ka thon se bile 15% e buxhetit duhet të kursehët këtë vit. “Gjithmonë ata e kanë dhanë at shumën e vet. E në kuadër të asaj shume që e kemi marrë si drejtori na kemi nda 60.000-70.000 për kulturë, 10.000 për sport edhe nja 10.000-20.000 për rini.”¹²⁸

Kryetari i Komunës duke ju thënë drejtorëve të kursejnë buxhetin për 15%, tregon për nivelin e ulët të autonomisë që këto drejtori faktikisht e kanë në shpenzimin e buxhetit. Edhe pse ekziston rregullorja për ndarjen e subvencioneve, centralizimi i buxhetit për kulturë mbetet në nivel të lartë. Sa i përket institucioneve të pavarura, për shkak se nuk ka konkurstë hapur, kërkesat mund të dërgohen për gjatë vitit në secilën kohë, ndërsa komisionet e vlerësimit përbehen nga bordi i drejtorëve e cila është e përbërë nga kryetari i komunës së bashku me secilin drejtor të drejtorive. Bordi i Drejtorëve në Prizren vendos per

¹²⁸ Intervistë me U.U

¹²⁷ Intervistë me Arhim Ajazi, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prizrenit, Prizren, gusht 2014.

shumat dhe për cilat projekte do të vendoset përkrahja.

Drejtori për kulturë, rini dhe sport kur pranon për herë të parë kërkesën, para se ta dërgoj tek bordi i drejtorëve paraqet në vija të trasha disa arsytetime për përkrahjen e festivaleve tradicionale “një pjesë e buxhetit shkon për manifestime tradicionale që na veç e dimë që kanë me ndodhë”¹²⁹ Në këtë rregullore ceket që baza për dhënien e subvencioneve janë kritere si: “Certifikata e regjistrimit; aktivitete e subjekteve ë synojnë ruajtjen, kultivimin dhe promovimin e vlerve kulturore, sportive dhe rinore; pjesëmarrja dhe furnizimi me mjete; përfaqësimi në nivel local, kombëtar apo ndërkombëtar dhe po ashtu subvencionimi I pjesëshëm I festivaleve të muzikës dhe filmit”

Peja po ashtu posedon një rregullore për ndarjen e subvencioneve, e cila nuk është publike aktual-

isht, Sipas drejtorit për kulturë, rini dhe sport çdo vendim është marrë duke u bazu në atë rregullore “ajo rregullore paraqet një demokraci jo të shkëlqyeshme por ashtu është, do të thotë çdo kërkesë duhet të i drejtohet kryetarit edhe drejtorit.”

Një Raport i realizuar nga Instituti Gap po ashtu në Pejë identifikon se në buxhetin e analizuar të vitit 2013 “Një shumë prej 1,060,000€ buxhetor për zyrën e Kryetarit të Komunës” dhe ankesat për si shpenzohët kjo shumë janë bërë publike nga ky raport “është orientuar në projekte jo praktike për të cilat nuk ka asnjë raport në lidhje me mënyrën e shpenzimit. Nuk janë caktuar kritere për ndarjet buxhetore dhe për pasojë buxheti nuk është ndarë në mënyrë të drejtë”¹³⁰

Sipas drejtorit për kulturë, rini dhe sport duhet patjetër të modifikohët mënyra se si ndahët buxheti. “Por 130 Instituti për Studime të Avancuara GAP, Praktikat e Buxhetimit në Gjashtë Komuna të Kosovës, (Prishtinë: Instituti GAP, 2014).

129 Intervistë me U.U

idea është që ne të kemi vija buxhetore për çdo ngjarje kulturore. Nëse i kemi 100,000 euro për kulturën atëherë ta definojmë, sa do të jenë për teatrin, sa do të jenë për festival, sa për aktivitete tjera kulturore.”¹³¹

Aktualisht në Pejë, buxheti për Kulturë, Rini dhe Sport është zero. Linja e subvencioneve është në zyrën e kryetarit të komunës. Kryetari i komunës së Pejës e ka një fond rreth 400,000 për subvencione. “Kërkesat që vijnë në drejtoratin e kulturës, rekomandohën nga drejtori tek komisioni për shqyrtimin e kërkesave. Komisioni i shqyrton dhe i rekomandon tek bordi i drejtorëve.”¹³² Sipas drejtorit për kul-

131 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

132 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

turë, rini dhe sport, këta “arrijnë dikund 150,000 euro me i tërheqë gjatë një viti”. Me këtë nivel të centralizimit, drejtoritë në Komunën e Pejës mes vete, vazhdimisht janë në një situatë ku duhet të llobojnë për rëndësinë e ndonjë projekti, në mënyrë që të kenë qasje në këtë fond.

Gjatë vitit 2014 janë nda subvencione, dikund 60 mijë euro për sport, 60 mijë euro për kulturë, edhe 10 mijë euro për rini. “Na sivjet i kemi marrë me rekomandimin e drejtorit, 60,000 euro për sport janë subvencionu klubet sportive. 50,000 euro deri tani organizatat kulturore, ndërsa 10,000 nga organizatat rinore. Kanë mbet tani edhe katër muaj që mundemi me tërheq edhe mjet financiar prej këtij fondi.”¹³³ Shifra e saktë se sa është investuar në kulturë, rini dhe sport

133 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitet e Kosovës”, gusht 2014.

mund të kuptohët vetëm në fund të vitit.

Sipas statutit të Graçanicës, “vetëm kryetari ka të drejtë ta menaxhoj dhe administrojë financat publike” por në nenin 49.2 të Statutit të Graçanicësëpo ashtu thuhet se “kryetari mund të ia delegoj këtë nën kryesuesit apo drejtorëve të departamentit”¹³⁴. Mirëpo në Graçanicë, sipas drejtorit për Arsim, kulturë, rini dhe sport vetëm kryetari menaxhon me këtë fond për momentin, “sepse kështu e rregullon statuti i komunës”.¹³⁵

Në Graçanicë nuk ka konkurs të hapur për pranimin e projekteve. Ato vlerësohen nga një komision i brendshëm. Një udhëhqës i një institucioni të pavarur të kulturës në Graçanicë ka treguar se këtë vit, dy herë ka aplikuar dhe I ka fituar projektet, po fillimisht ka pasë takime me këshilltarët e kryetarit.

134 Komuna e Graçanicës, Statuti i Komunës së Graçanicës, (Graçanicë, 2013).

135 Intervistë me drejtorin dkrs gracanice

Buxheti publik për Institucionet Publike të kulturës

Institucionet publike të kulturës në nivel lokal bëjnë pjesë në organogramet e komunave, që i bën këto institucione pjesë e organizimit të brendshëm të komunës. Kjo zgjidhje ka implikime financiare dhe në menaxhim. Sikur në nivel qendror, punëtorët e këtyre institucione publike të

kulturës janë të punësuar në komunë. I vetmi dallim nga niveli qendror dhe katër komunat të cilat kanë qenë pjesë e analizës në këtë hulumtim sa i përket shpërndarjes së mjeteve, është se këto institucione nuk kanë buxhet për produktion, përveç pagave dhe shpenzimeve të përgjithshme, i cili ju ndahet në fillim të vitit.

Në Prishtinë udhëheqësit e Dodonës janë shprehur se “kanë vështirësi të mëdha edhe për të siguruar fonde edhe nga donatorët e jashtëm për shkak se ata kanë krijuar bindjen që Dodona menaxhohet nga komuna, kështu që dhe janë mjaft

të qëndrueshmë”¹³⁶ “Kishte qenë shumë normal, ne me pasë një buxhet” është shprehur drejtori i Teatrit Dodona. Mirëpo aktualisht, institucionet e kulturës në varësi të komunës së Prishtinës, për projektet e tyre financohen përmes vijës së subvencioneve. Sipas drejtorës aktuale për Kulturë, Rini dhe Sport “Në rregullore për subvencione edhe ma tutje lejohet, që me ardh me konkurrenca institucionet publike. Ka vazhdu me mbet kështu derisa nuk bëhet ndonjë zgjidhje për institucionet vartëse tona, sepse nëse e ki një institucion që varet me njëfarë mënyre, është mirë me pasë një buxhet”¹³⁷ Aktualisht institucionet publike të kulturës ju alokohet buxheti në bazë të projekteve.

Sipas Drejtorit të teatrit Dodona “kjo nuk është në rregull, sepse ti gjithmonë duhësh me apliku në ko-

¹³⁶ Interviste me Agron Shala dhe Valdet Rama, Teatri i Qytetit Dodona, Prishtinë, gusht 2014.

¹³⁷ Interviste me Blerta Zeqiri, Drejtore, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës, Prishtinë, prill 2014.

munë si gjithë të tjerët a në anën tjetër je i themelum prej komunës. Ne nuk kemi buxhet fare.”¹³⁸ Por gjatë intervistës me udhëheqësit e Dodonës është kuptuar që deri më tani në këtë vit janë përkrah 2 projekte. Teatri Dodona aplikon në katër fazat e ndryshme të subvencioneve në komunën e Prishtinës, në mënyrë që të realizojnë shfaqjet e parapara.

Në Prizren, teatrit të qytetit i alokohet 7000 euro në vit për shfaqje, për të cilat arrin të i realizoj dy shfaqje, dhe të cilat nuk janë të mjaftueshme. Edhe këto 7000 euro ndahen dhe alokohen gjatë vitit. Ndërsa sipas drejtorit të teatrit të Prizrenit “me ligj duhet të realizohen katër shfaqje”¹³⁹ Ndërsa për rritjen e buxhetit për projekte, drejtori i drejtorisë për kulturë, rini dhe sport i ka sygjeru teatrit të Prizrenit

138 Intervistë me Agron Shala Valdet Rama, Teatri i Qytetit Dodona, Prishtinë, Gusht 2014.

139 Intervistë me Fetah Paçarizi, Drejtor, Teatri i Qytetit të Prizrenit, Prizren, gusht 2014.

që në dëgjimet publike të avokojnë tek kryetari i komunës për ma shumë buxhet”¹⁴⁰

Në Pejë po ashtu ka probleme në alokimin e buxhetit të institucioneve publike. Galeria e Arteve, është e paraqitur si department në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe po ashtu gjindet në këtë ndërtesë. Nuk ka buxhet, por financohet në bazë të projekteve. “Mungon buxheti. Asnjëherë nuk është parapa një buxhet për Galerinë e Arteve, dhe unë e shoh vështirë që edhe në vitet në vijim të ketë një buxhet të ndarë për Galerinë e Arteve.”¹⁴¹ “ Buxheti i teatrit të Pejës sillet rreth 30.000 euro prej komunës, ndërsa Ministria e Kulturës është duke e mbështet me 10,000 euro buxhet në vit. “Por këtë vit

140 Intervistë me Arhim Ajazi, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna Prizren, gusht 2014.

141 Englebert Zefaj, Drejtor, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Pejës, në konferencën e organizuar nga Forumi Kulturor “Kultura në Komunitat e Kosovës”, gusht 2014.

komuna është vonu në alokimin e buxhetit, si duket për shkak se nuk është miratu këshilli drejtuës i teatrit, dhe për këtë arsye teatri ende nuk ka marrë buxhet nga komuna.”

Sa i përket Graçanicës, e cila është komunë e themeluar në vitin [...] si komunë e re, e cila deri në këtë moment ka qenë pjesë e komunës së Prishtinës, gjatë procesit të decentralizimit, ku ende vazhdojnë të ekzistojnë në sferën e kulturës institucionet e Sërbisë, alokimi i buxhetit prej Komunës në institucionet e kulturës publike bëhet përmes vlerësimit të kërkesave. Sipas drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport sa ju përket institucioneve publike ai shprehet se “Ata perkrahen. Do të thotë, ata e marrin pagën. Kurse të tjerët ndahen përmes organizatave joqeveritare ose projekteve të ngjajshme.” Nuk ekziston pika e financimit të shtëpive të kulturës, ekziston vetëm pika për pagën. Do të thotë edhe në Graçanicë nuk marrin buxhet, por drejtori ka treguar që nuk ekziston

as pika buxhetore për shërbimet, dhe nuk mund të realizojnë as pagesën e shpenzimeve. Ndërsa pjesa tjetër e punëtorëve paguhet nga institucionet e Sërbisë.

QASJA NË SHFRYTËZIMIN E PRONËS KOMUNALE PËR VEPRIMTARI KULTURORE

Niveli i dytë i marrëdhënies në mes të institucioneve të pavarura dhe komunave, e cila paraqet interes për veprimtarinë kulturore në këto komuna, është qasja në shfrytëzimin e pronës komunale për veprimtari kulturore. Në Prizren ka një shembull se si është dhënë hapësira publike dhe është krijuar hapësirë për veprimtari kulturore të një institucioni të pavarur të kulturës. Dokufest, ka arritur të funksionalizojë kinemanë e re të qytetit dhe kjo hapësira i është dhënë në shfrytëzim këtij institucioni, në fazat kritike të investimit të përbashkët të Komunës së Prizrenit dhe Bashkimit Evropian.

Në bazë të kësaj përvoje, shembullin e njejtë janë duke e ndjekur edhe Anibar në Pejë, më ndihmë dhe asistencë nga Dokufesti dhe QKK. Për shkak të ambiguitetit, procedurave të zgjatura, apo komplikimeve ligjore që ekzistojnë rreth çështjes se si të merret në shfrytëzim publik një pronë komunale nga institucionet e pavarura të cultures për

veprimtari jo-profitabile kulturore, Anibar-it në këtë process është ndihmuar edhe Dokufest, pasi që e kanë kalu atë fazë më herët. “Në fillim ndihma ka qenë për festivalin e animacionit, sepse po dilte diçka e re. Mandej kur e kemi pa që kemi pa që kanë nevoj për ndihmë... sidomos teknike... Ju kemi ndihmu edhe në lidhje më kinemanë. Bisedat kanë ndodhë me Kryetarin e Komunës. Sepse e kemi pa qënës ai është i gatshëm, na jena për me iu ndihmu me një process të gjatë në të cilin kemi kalu për distribucion e filmave, dhe i kemi udhëzuar... e nëse ata janë të gatshëm... ajo vlenë”.¹⁴²

Sipas Vullnet Senajës “ Na kemi bashkëpunu me Dokufestin, në aspektin, që me marrë përvojën se si e kanë rifunksionalizuar kinemanë e qytetit, edhe kemi pasë takime të vazhdueshme me DKRS-në dhe KK, ku ju kemi spjeguar atyre sa është e rëndësishme me pasë një kinema funksionale në qytetin tonë, dhe ju

¹⁴² Intervistë me Veton Nurkollari, Drejtor, Dokufest, Prizren, gusht 2014.

kemi dërgu një projekt propozim se si ne kishim mujt me menaxhu kinemanë.”¹⁴³

Drejtuesit e Anibar-it të deri tash kanë bërë një punë të gjatë në këtë proces. Por ende “nuk është zyrtarizu asgje pasiqë ne jemi duke e shiku mënyrën ma të mirë qysh me ba këtë punë, pa pasë ndonjë pengesë, ligji ose çkadoqoftë tjetër. Mundet me qenë edhe vullnet politik i kryetarit të komunës,që me ja jep, domethënë me nënshkru një memorandum mirëkuptimit dhe organizatës e cila po dëshiron me u vendos, që ka interes, edhe resurse humane dhe teknike për me zhvillu aktivitete në qat object. Njejtë ka ndodhe edhe një OJQ-së ERA, ata janë vendosë aty, pasiqë kanë fitu një projekt prej SIDËS.”¹⁴⁴

Sipas ligjit “1. Kuvendi i Komunës themelon Komisionin e posaçëm në përbërje të përfaqësuesve të ekzekutivit të komunës dhe Kuvendit të Komunës të cilët vlerësojnë ofertat dhe i propozon Kuvendit listën e ngushtë prej së paku tre pretendentëve kryesor për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajshme publike komunale.”¹⁴⁵

Komuna duhet të pajiset me leje për dhëniën në shfrytëzim të pronës nga Ministria për planifikim hapësniar. Mandej kuvendi komunal e bon një komision për vlerësimin e ofertave ...por nuk mundet dikush privat me përfitu prej kësaj. “ është thënë gjatë intervistave.

Sa i përket institucioneve publike, në rastin kur, institucionet e kulturës të cilat themelohen nga mekanizmat shtetëror, atëherë ligji e obligon komunën që të siguroj hapësirën për veprimtarinë, si dhe pagat për punëtorët.

Në nivelin komunal, mos pasja e një strategjie dhe obligimi ligjor, por edhe synimit që e sheh këtë element si të rëndësishëm dhe për-

145 Ligji për dhëniën në shfrytëzim të pronave publike

143 Intervistë me V.S

144 Intervistë me V.S

parësi të komunave në raport me nivelin qendror të pushteit, dhe në raportin në mes komunës dhe institucioneve të pavarura të cultures, por sidomos në raport me interesin e përgjithsëm për të krijuar hapësirë për lulëzimin e veprimtarisë të pavarur kulturore, i ka reduktu komunat në financues dhe ndikues të vogël në zhvillimin e veprimtarisë kulturore në Kosovë.

Shtojca I:

Lista e të Intërvistuarëve

Agron Shala, Drejtor, Teatri Dodona
Arhim Ajazi, Drejtor, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Komuna e Prizrenit

Bekim Lumi, Regjisor/ Profesor, Universiteti i Prishtinës

Blerta Zeqiri, Drejtore, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës

Dragan Dimitrijevic, Drejtor, Drejtoria për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, Komuna e Graçanicës

Fetah Paçarizi, Drejtor, Teatri i Qytetit të Prizrenit

Florent Mehmeti, Drejtor, Teatri ODA

Gent Gorani, Drejtor, Festivali Into the Park

Hana Qena, Drejtore, Festivali SKENA UP

Jeton Neziraj, Drejtor, Qendra Multimedia

Mensur Bytyqi, Drejtor, Drejtoria për Zhvillimin e Turizmit, Komuna e Prizrenit

Mustafe Halili, Drejtor (2002-2007), Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Prishtinës

Nenad Maksimovic, Drejtor, AKC Center

Niman Muçaj, Drejtor, Teatri i Qytetit të Pejës

Nita Deda, Menaxhere e Komunikimeve, Dokufest

Urim Ukimeri, Kordinator për Kulturë, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Komuna e Prizrenit

Valdet Rama, Menaxher, Teatri Dodona

Veton Nurkollari, Drejtor Artistik, Dokufest

Vullnet Sanaja, Drejtor, Festivali Anibar

Zika Rakocevic Drejtor, Shtëpia e Kulturës, Graçanicë

Zymer Mulliqi, Drejtor, Galeria e Arteve, Pejë

Rekomandimet

Rekomandimet

Në bazë të diskutimeve të zhvilluara gjatë fokus grupit rezulton edhe lista e mëposhtme e rekomandimeve:

- RTK, si medium i vetëm publik në Kosovë, si në radio ashtu edhe në televizion, të kenë kanale të veçanta të dedikuara kulturës dhe artit. Përpos distribuimit të informacionit rreth ngjarjeve kulturore kulturës dhe të artit, dhe me qëllim të emancipimit kulturor dhe edukimit të shijes artistike në përgjithësi, të emitohen përmbajtje kulturore, dokumentarë, debate, diskutime me autorë dhe kritikë, etj.

- MKRS-ja të përkrahë më shumë portale dhe platforma informative që janë të dedikuara artit dhe kulturës.

- Mediet duhet të investojnë më shumë në rubrikat e kulturës. Të rekrutohen gazetarë të cilët kanë përgatitje adekuate për mbulimin e kësaj fushe, si dhe të mos diskriminohen në aspektin financiar në raport me gazetarët e rubrikave të tjera.

- Mediet duhet të ndërtojnë partneritet me prodhuesit artistikë, me ç'rast në këmbim për më shumë hapësirë në medie, prodhuesit artistikë, duke iu ofruar mundësi të mbulimit të koncerteve, recitale, festivaleve, etj.,

iu bëjnë të mundshme përmbajtje më të pasur të programeve kulturore të tyre.

Forumi Kulturor

Teatri Oda organizoi një mori takimesh informative gjatë fundvitit 2011 me qëllim të krijimit të një rrjeti të përbashkët të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime morën pjesë më se 60 pjesëmarrës, përfaqësues nga organizata të ndryshme të kulturore dhe kështu u krijua mundësia e organizimit të Kuvendit themelues, i cili u mbajt me 23.03.2012 dhe vuri themelet e Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi Themelues vuri themelet e Forumit Kulturor duke anëtarësuar 22 organizata të pavarura në kuadër të Rrjetit. Përmes votave demokratike u aprovua statuti, njëkohësisht u zgjodh edhe Kryesia e rrjetit. Forumi Kulturor është etnitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura kulturore si anëtare. Si Sekretariat i përkohshëm i Forumit Kulturor është vendosur të jetë Teatri ODA deri në momentin e ngritjes së kapaciteteve për të formuar një Sekretariat profesional të rrjetit.

Forumi Kulturor i Kosovës është Rrjet i Organizatave të Pavarura të Kulturës të Kosovës themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të pavarura kulturore, duke i zhvilluar kapacitetet e

tyre për realizimin e programeve të tyre,

- Afirmimit të organizatave anëtare,

- Përfshirjes së organizatave anëtare në proceset vendimmarrëse,

- Rritjes së përkrahjes së skenës së pavarur të kulturës,

- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

Forumi Kulturor synon të përmbushë misionin e vet nëpërmjet aktiviteteve si:

- Komunikimi dhe rrjetëzimi i organizatave të pavarura në fushën e kulturës

- Shkëmbimi dinamik i informacioneve dhe përvojave

- Aktivitetet e lobimit dhe avokimit

- Trajnimet specifike për nevojat e organizatave anëtare

- Organizimi i debeteve dhe forumeve

- Bashkërenditja e aktiviteteve artistike dhe kulturore

Forumi për Zhvillim Kulturor

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë më tutje dhe të forcojë Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke ofruar këshilla dhe njohuri të vlefshme për politikatat kulturore të Kosovës. Projekti është i mbështetur nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë, e bartës të projektit janë Forumi Kulturor, Teatri ODA dhe Do-kuFest. Projekti ka filluar me aktivitetet e para në dhjetor të vitit 2013, ndërsa parashihet të zgjasë deri në nëntor të vitit 2015. Në një periudhë dy vjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të prodhojë të paktën 28 produkte të politikave të kulturës, të cilat do të rezultojnë nga hulumtime, debate, fokus grupe dhe konferenca. Projekti do të forcojë rrjetin e komunitetit të kulturës së pavarur, të ndërtojë kapacitetet e saj të brendshme dhe të ndikojë në hartimin e politikave kulturore të Kosovës përmes prodhimit të dijes për kulturë. Po ashtu, projekti do të nxisë dialogun dhe bashkëpunimin mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të dalë me zgjidhje konkrete për zhvillimin kulturor në Kosovë.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor



forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor